

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

**Data 15.04.2023
Ora, 11:02**

RENDI I DITËS

**“Për shqyrtimin e kërkesave të televizioneve “Report TV” dhe “News 24”
për akreditim vëzhgimi për vëzhgues për zgjedhjet e datës 14 maj.”**

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

- | | |
|--|-----------------------------------|
| 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z. Ilirjan Celibashi |
| 2. Staf i KQZ: | Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja |

• **Parti Politike:**

PD, PS, PL

• **Të tjerë:**

KRIIK, ODIHR

Z. I. Celibashi: Mirëmëngjesi, të gjithëve! Atëherë, në rendin e ditës të seancës së sotme publike kemi këto çështje: projektvendim për miratimin e përmbajtjes së fletës së votim për kandidat për kryetar të Bashkisë së Tiranës; projektvendim për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidat për anëtar të këshillit të bashkisë së Tiranës; projektvendim për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët dhe për anëtarë të këshillit bashkiak për bashkitë e tjera; shqyrtimi i kërkesës së televizioneve “Report TV” dhe “News 24” për akreditim vëzhgimi për vëzhgues për zgjedhjet e datës 14 maj, vlerësimi i e raporteve për veprimtarinë me karakter publik të institucioneve të ndryshme dhe të mbartur kemi çështjen që lidhet me verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

subjektin vetëdeklarues zotin Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për kryetar të Bashkisë së Mallakastrës i propozuar nga Partia Socialiste. Nëse edhe përfaqësuesit e partive politike janë dakord unë do të propozoja që të kemi këtë radhë: shqyrtimin e kërkesave që lidhen me akreditimin e vëzhguesve; raportimin për veprimtaritë publike dhe pastaj vazhdojmë me fletët e votimit dhe me të tjerat.

Z. I. Sefa: Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Z. I. Celibashi: Ju lutem, me radhë. Nëse kemi konsensus, nëse nuk kemi, do të ndjekim këtë radhë.

Z. E. Salianji: Unë jam dakord zoti Komisioneri të mbarojmë këto që janë pa debat se do të na hajë pak kohë kjo pjesa e punës së fletës.

Z. A. Kaziaj: Të njëjtin mendim ndaj edhe unë me kolegun.

Z. I. Celibashi: Besoj se kemi edhe mirëkuptimin e përfaqësuesit të Partisë Socialiste. Atëherë, fillojmë me shqyrtimin e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve për dy televizionet dhe pastaj për raportin.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Televizioni “Raport TV”, ka paraqitur para Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 64 gazetarëve dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur dhe dokumentacioni, respektojmë afatin e kohës së përcaktuar në nenin 6 pika 5 të Kodit Zgjedhor, dhe televizioni “Report TV”, është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të caktuara

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

në nenin 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, televizioni “News 24”, ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 51 gazetarëve, të cilët do të bëjnë vëzhgimin e tyre. Edhe dokumentacioni i këtij televizioni është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor. Për këtë arsye i kërkojmë Komisionerit akreditimin e gazetarëve të televizioneve “Report TV” dhe “News 24”. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Besoj se përfaqësuesit e partive politike janë dakord. Atëherë, miratojmë kërkesën e dy televizioneve për akreditimin e vëzhguesve për vëzhgimin e zgjedhjeve të datës 14 maj të vitit 2023.

Vendimi nr. 364

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

**Data 15.04.2023
Ora, 11:03**

RENDI I DITËS

“Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 31 mars – 6 prill 2023.”

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja**

• **Parti Politike:**

PD, PS, PL


• **Të tjerë**

KRIK, ODIHR

Z. I. Celibashi: Po, Madalena për raportin për veprimtaritë e institucioneve publike.

Znj. M. Koja: Sot kemi në rendin e ditës shpalljen e vendimit për periudhën e monitorimit të vlerësimit të raporteve për përdhën 31 mars - 6 prill. Subjekte të këtij vendimi janë disa institucione qendrore dhe vendore, konkretisht: Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Banka e Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Prefekti i Qarkut të Beratit dhe Bashkia e Kamzës. Do të ndalem shkurtimisht, në rastin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit bëhet fjalë për dy aktivitete, ku ky institucion ka qenë i ftuar, pra rrjedhimisht nuk ka pasur detyrim as të raportojë dhe në këto kushte është në shkelje të afatit ligjor; sa i përket

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

veprimtarisë së Ministres së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes të dyja këto ministre kanë raportuar për një veprimtari ku kanë qenë të ftuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe kështu që në këto kushte nuk kanë detyrim për raportim dhe për këtë arsye ka ardhur shkelja e afatit të raportimit, Banka e Shqipërisë, edhe ajo është në kushtet e të ftuarit në një aktivitet të Akademisë të Shkencave ndërsa aktivitetit i dytë është një intervistë dhe për nga natyra e tij nuk është veprimtari që raportohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Për sa i përket Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile ka lapsus në raportim, në vend të raportonin muajin prill, kanë raportuar marsin, sikur të kishin raportuar saktësisht do të ishim në respektim të afateve. Ndërsa për sa i përket Prefektit të Qarkut Berat, është një takim pune, i një komiteti, pra është me natyrë administrative për këtë arsye nuk është me natyrë veprimtari publike. Një situatë të ngjashme ka edhe Bashkia Kamzë, ka raportuar gabimisht muajin mars në vend të muajit prill. Në këto kushte nuk konstatojmë shkelje administrative nga ana e këtyre institucioneve dhe propozojmë pushimin procedimit administrativ ndaj tyre. Faleminderit.


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partisë politike a keni ndonjë mendim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës? Nuk kemi.

Z. E. Salianji: Mundem?

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i Partisë Socialiste.

Z. E. Salianji: Dëgjova me vëmendje raportin, ky lloj raportimi, që vjen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga subjektet shtetërore, vjen si pasojë e një

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

kujtese që ky institucion i ka çuar institucioneve dhe ka krijuar një kakofoni për sa i përket mënyrës se si raportohet dhe çfarë duhet të raportohet. Ne, këtij Komisioni, si subjekt i Partisë Socialiste, i jemi drejtuar me një shkresë-kërkesë, rreth 1 muaj e gjysmë më përpara, ku i kemi thënë, që të mos krijohet kjo situatë institucionet të mos vijjnë këtu të raportojnë punën e përditshme. Komisioneri ka detyrimin, dhe KQZ-ja nëpërmjet Rregullatorit duhet të miratonte një udhëzim që të mos ishim në këtë situatë, pasi koha e këtij institucioni që është për të organizuar zgjedhjet dhe administratës, shumë e çmuar, është një punë e administratës që raportohet në 10 minuta, por është një punë që mund të kërkojë disa orë kohë nga administrata e KQZ për të verifikuar këto raste, të mos shkonte dëm. Po të kishim sot një udhëzim të qartë nga Rregullatori, nuk do të ishim përballë këtij fakti që të gjithë institucionet, që duke u bazuar në një kujtesë të Komisionerit sjellin këtu informacione, të cilat nuk janë të detyrueshme për ta, si dhe nuk janë të nevojshme për Komisionerin. Jemi në kohë, mundet edhe tani, sepse tani ka filluar fushata zgjedhore, sot jemi 30 ditë para zgjedhjeve dhe unë mendoj të hartohet një rregullore, një udhëzim i qartë nga Rregullatori dhe t'u bëhet me dije me shkresë këtyre institucioneve se cilat janë detyrimet e tyre konkrete. Nuk mund të thuhet: të lexohet ligji, ligjet ne lexojmë shumë qartë, nuk kanë detyrim të raportojnë për veprimtaritë, të cilat i kanë objekt të punës së tyre, por duke u bazuar në atë kujtesë, tashmë dihet që në periudhë zgjedhore Komisioneri dhe emri i Celibashit merr një lloj, është target, kur i shkon institucioneve, na e ka sjellë Celibashi thonë kujtesën, nuk e shikojnë kujtesë, por e shohin urdhër dhe vazhdon i gjithë shteti sjell dokumente këtu që nuk duhet t'i sje. Tani vetë e keni krijuar, Komisioner, këtë kakofoni, ju kërkoj prapë, publikisht, të hartoni një udhëzim të qartë në lidhje me mënyrën dhe formën se si organet shtetërore publike duhet të sillen në fushatë, të sjellin kërkesat këtu, si dhe të zbatohet me rigorozisht ndaj institucionit qendrorë. Pra, ne jemi që institucionet

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

shtetërore të bëjnë punën e tyre dhe fushata të vazhdojë, por, që ta mbajmë këtë, duhet patjetër një rregull nga ana juaj meqenëse është edhe një risi në Kodin Zgjedhor kjo lloj veprimtarie, si dhe për zgjedhjet vendore nuk është i trajtuar nga Kodi Zgjedhor. Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, Eridian! Unë mendoj që edhe pa kujtesat, që ne iu kemi nisur institucioneve publike në Kodin Zgjedhor, qoftë në germë, po qoftë edhe në frymën e tij, por edhe në aktet e Rregullatorit, është i qartë dallimi ndërmjet veprimtarive publike dhe veprimtarive politike. Nuk kanë asnjë detyrim për të raportuar veprimtaritë politike dhe elektorale. Nëse ka qenë rasti, kur i kanë raportuar, ky nuk është problemi ynë, ky është problemi i përfaqësuesve tuaj, të cilët ndoshta me një rigorozitet të shtuar, por të panevojshëm në këtë rast, kanë dashur të raportojnë edhe veprimtaritë politike për të cilat ne nuk kemi interes.

Z. E. Saliانji: Po, raportohen edhe mbledhjet e punës së tyre. Politika dakord, por bën prefekti mbledhje, raporton ta bëj mbledhjen apo jo me stafin. Pra, ti boll halle ke për këtë që je, për mbledhje, tani të shikosh edhe bën mbledhje në Berat ai apo nuk bën.

Z. I. Celibashi: Jam plotësisht dakord dhe atë, jam duke thënë që ne e kemi bërë të qartë në aktet tona se cili është dallimi ndërmjet një veprimtarie institucionale publike dhe një veprimtarie politike. Nëse personat e konfundojnë këtë dhe nuk arrijnë të bëjnë dot dallimin, mendoj se ne nuk kemi çfarë të bëjmë më shumë, është i qartë dhe mendoj që ekziston nga çdo pikëpamje qartësia për të bërë këtë dallim. Rasti, i cili mund të marrë një lloj diskutimi është rasti i kandidatëve për kryetar bashkie, të cilët janë dhe kryetar bashkie në detyrë, ata ndoshta mund të kenë një

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

vështirësi, por përsëri, në vlerësimin tonë, është shumë e qartë, ose do të sillen si kryetar bashkie, në momentin kur janë duke kryer një veprimtari të caktuar, ose do të sillen si kandidatë, të lutem, në rastin kur sillen si kandidatë nuk do të duhet që të angazhojnë fonde publike, asete publike, stafin e bashkisë, logon e bashkisë, nuk duhet të përdorin rrjetet sociale të bashkisë. Ky është kuptimi i ligjit.

Z. E. Salianji: Jam dakord me të gjitha këto që the ti, kjo është ajo që duhet të bëjmë, por ku janë të shkruara që t'i lexojmë dhe t'i zbatojmë?

Z. I. Celibashi: Po e ka ligji, pra.

Z. E. Salianji: Po nuk e ka ligji kështu.

Z. I. Sefa: E ka akti i Rregullatorit këtë.

Z. E. Salianji: Mesa shoh unë ju e keni shumë të qartë, kështu duhet të jetë, për një që e kupton ligjin, që është specialist i kësaj gjëje, jemi ok, por e gjithë Shqipëria nuk e njeh ligjin, siç e njeh Kryetari i KQZ, ne shpresojmë që e njohim, dhe themi interpretojeni. Ata kanë nevojë për një udhëzim dhe ky udhëzim është ato që ju thoni, hajdeni i shkruajmë dhe ia dërgojmë. Pra, jam dakord me këtë që thoni.

Z. I. Celibashi: Ne ia kemi përcjellë në kujtesë ia kemi përcjellë dhe interpretimin tonë në funksion të ligjit dhe shohim që në një pjesë të madhe ka reflektim dhe kanë kuptuar, ka një pjesë, të cilët akoma nuk e kanë kuptuar dhe kemi keqardhje për këtë, por, gjithsesi, përtej asaj, ngelet për t'u evidentuar fakti që ka interes edhe vëmendje

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

për të ndjekur udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Diku kjo nuk funksionon, nuk funksionon nga padijenja, nga dashja këtë nuk e themi dot.

Z. A. Kaziaj: A mundem të flas, Komisioner, për të mos bërë shumë debat?

Z. I. Celibashi: Po.

Z. A. Kaziaj: Eridiani kishte kohë pa ardhur në këtë komision, tani është kënaqësi ta dëgjosh që i qan hallin Komisionerit për ngarkesën e madhe që paska Komisioneri ndaj detyrimit ligjor që vjen për shkak të Kodit Zgjedhor dhe të vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator. Flasim për gjëra shumë të qarta, që tashmë i dimë fare mirë, janë të shkruara shumë mirë dhe nuk ka nevojë për një udhëzim udhëzues të një vendimmarrje të një komisioni kolegjal në këtë institucion. Fakti është se megjithëse e kanë fryrë, të themi, të gjithë administratën shtetërore, duke dyfishuar apo trefishuar numrin, nuk paskan gjetur një person që kuptoka ligjin se kur duhet raportuar dhe kur nuk duhet raportuar, duke incentivuar në këtë rast mosraportimin. Kjo është skandaloze, të dëgjosh një përfaqësues ligjorë, që kërkon, incentivon mosraportimin e një aktiviteti, të cilin ligjvënësi e ka vënë si detyrim për raportim nga ana administratës shtetërore me atë shkakun ose me motivin që ju ngarkoheni dhe duhet të fokusoheni te zgjedhjet, ndërkohë që dhe kjo është pjesë e zgjedhjeve në fund të fundit, është për balancimin e armëve të përfaqësuesve politikë, të subjekteve që marrin pjesë në zgjedhje. E dimë shumë mirë, që vetë, me iniciativë nga ndryshimet e vitit 2020 me ligjin 101 dhe 118 ka pasur mosraportime, ka pasur aktivitete të palejuara që janë bërë në mënyrë abuzive nga ana shtetit dhe ju vetë keni marrë vendimmarrje ndëshkuese, gjobëvënëse kundrejt tyre. Kështu që ju ftojme, ju, si Komisioner, administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

shoqëritë civile, KRIIK, Qëndresa Qytetare dhe të gjithë të tjerët, qytetarët që shikojnë një paligjshmëri të mos hezitojnë po ta denoncojnë dhe jo të bëjnë të kundërtën, siç tha kolegu Salianji. Faleminderit.

Z. E. Salianji: Unë nuk do të merresha, sepse, në fakt, me kolegët gjithmonë debatin e kemi pasur përballje, jo në krah, dhe nuk dua ta bëj dhe këtë rrallë debat me kolegun. Kemi mbështetur faktin që veprimtaria publike nuk duhet të ngatërrohet me fushatën dhe për atë jemi. Këtë e provon dhe vetë fakti që sot bëmë një mbledhje dhe hamë këto minuta dhe nga 10 institucione del fare e qartë dhe është prova që të 10 kanë bërë punën e tyre vetëm janë afruar në raportim. Pra, këtu organizohen zgjedhjet, por me këtë rast po marrim vesh si funksionon shteti. Pra, po i bëhet një probabilitet administratës shtetërore që vjen dhe raporton pa ia kërkuar njeri, thjesht nga një ngatërresë që aknë ata për interpretimin e ligjit. Kemi qenë dhe jemi që administrata shtetërore nuk përdoret për fushatë. Këtë e provon dhe kjo vendimmarrja e sotme janë 10 organe, të cilat kanë raportuar gabimisht. Kemi mbështetur të gjitha institucionet dhe të gjitha shoqatat të cilat ku ka shkelje të ligjit për përdorim të administratës shtetërore në fushatë të jenë këtu në këtë institucion të denoncojnë. Me mosprezencën tonë kemi bërë që nuk kemi ankuar kundër gjobave që janë vënë ndaj institucioneve, të cilat kanë shkelur ligjin. Pra, vetë Partia Socialiste me mosanikimin e atyre vendimeve i ka pranuar këto lloj gjobash, të cilat ka vendosur Komisioneri. Kjo do të thotë që këtu nuk jemi fare në atë që tha kolegu që shiko ne po bëjmë këtu që administrata të mos përdoret fare. Themi: nuk do të përdoret administrata të vendosim një rregull një udhëzim që të themi deri këtu e keni vijën e kuqe që ju duhet të bëni punën tuaj dhe deri këtu e kanë partitë politike që të ndikojnë në administratë. Dhe këtë e bën një udhëzim fare i qartë, që është i Rregullatorit. Po të kishte vullnet nga forcat politike dhe opozita ta kishte kërkuar

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

siç dhe ne e kemi kërkuar. Në nuk kemi kërkuar të mos kontrollohemi, ne kemi kërkuar që të mirë kontrollohen këto, hajdeni të hartojmë një udhëzim, se si do të funksionojë fushata zgjedhore dhe si do të funksionojë administrata. Nuk është bërë ky udhëzim. Këtu janë bërë me dhjetëra udhëzime, me qindra. Thuhet që ecet me kujtesa, shteti, nuk ecën me kujtesa, shteti ecën me letra, me ligje udhëzime të cilat janë kompetencë e Komisionerit dhe e Rregullatorit. E them edhe një herë nuk përdoret administrata në fushatë, nuk e mbështesim këtë përdorim. Në rastet kur është shkelur nuk e kemi ankimuar. Kanë ndodhur raste që është shkelur, janë vënë gjoba patjetër ata që e kanë shkelur të paguajnë gjobën, dhe kjo ka ndodhur, në rastet që ne jemi interesuar se ka pasur një mosndarje të qartë të ligjit. Ata që e kanë shkelur nuk e ndanin dot, kryetari i bashkisë është kryetar bashkie apo kandidat. Që në periudhë zgjedhore kryetari i bashkisë normal, duhet të sillet si kandidat dhe do të bëjë fushatë dhe ka të gjithë të drejtën e mundshme. Duhet dhe këtu të vihet një vijë e kuqe për ta ndarë që është shumë e hollë për ta ndarë kur je kandidat në këtë periudhë dhe kur je kryetar bashkie. Thuhet për rrjetet sociale. Nuk thotë gjë ligji për rrjetet sociale. A doni që edhe kjo të ndikojë hajdeni, e shënojmë në udhëzim, e miratojmë dhe jua tregojmë dhe pastaj e zbatojmë. Prandaj unë e quaj debat dhe debati im vetëm se si ta normojmë që të mos shkelet dhe jo të krijojmë shkelje.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Z. I. Sefa: Zoti Komisioner, unë jam me idenë që më mirë të raportojnë se të mos raportojnë. Le të ngarkohet Komisioneri me punë, le të ngarkohet pak Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Është shumë më mirë të raportojnë, edhe pse raportojnë gabim është mënyra si e njohin ligjin dhe si e bëjnë dhe zbatimin e tij institucionet vendore dhe të cilat kanë për detyrë ta njohin atë. Unë më shumë se kaq, kam një shqetësim

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

më të madh të them të drejtën për të cilin Komisioneri dhe ky Komision duhej të kishte marrë masa imediate. Janë ndërhyrjet e qeverisë në procesin zgjedhor, siç edhe Komisioneri është në dijeni, dhe, siç edhe ka mbajtur qëndrime më përpara, siç është propozimi për rritjen e pensioneve, propozimi për rritjen e pagave, shtimet në administratën shtetërore, e të tjera me radhë në kundërshtim të hapur me nenin 92 të Kodit Zgjedhor. Komisioneri ka disa kohë që nuk mban qëndrime në lidhje me këto veprimtari të qeverisë shqiptare, të cilat, në konceptin tonë dhe në mënyrën si e lexojmë në ligjin, janë të ndaluara nga Kodi Zgjedhor, pavarësisht se kanë një interpretim të zgjeruar të ligjit nga ana e qeverisë shqiptare, por ne mendojmë se ato janë ndërhyrje të drejtpërdrejta në procesin zgjedhor dhe KQZ-ja dhe Komisioneri duhet të marrë masa duhet të kishin marrë masa, të them të drejtën, por jemi në fazën që kemi ende një vendimmarrje nga ana e Komisionerit në lidhje me këto fenomene të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në procesin zgjedhor. Ky është shqetësimi më i madh. Pastaj, nëse institucionet raportojnë më shumë mirë, le të vijnë le të raportojnë çfarë të kenë, nuk është problem, pastaj është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Komisioneri që vlerëson, nëse janë ato veprimtari që duhen raportuar apo jo. Ky ishte shqetësimi im më i madh, unë mendoj që Komisioneri duhet të ketë rol më aktiv në këtë proces në këtë proces dhe roli që na garantohet nga Kodi Zgjedhor për vendimmarrje të drejta, të cilat garantojnë proces të rregullt zgjedhor. Kjo është më e rëndësishmja dhe shqetësimi primar që kemi ne.

Z. I. Celibashi: Faleminderit për kontributet tuaja në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës! Atëherë, do të vendosim e do të disponojmë për këtë raportim në një nga ditët në vijim.

Vendimi nr. 365

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

15.04.2023
Ora 11:20

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaç, Znj. M. Koja, P. Docaj**
- **Parti Politike:** **PDIU, PS, PD, BF, Lëvizja Bashkë**
- **OJQ:** **KRIIK, ODIHR**

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit, kemi fletën e votimit për kryetar të bashkisë së Tiranës dhe të këshillit bashkiak. Mund të fillojmë me këtë të këshillit bashkiak, se mendoj se mund të gjejmë konsensus më shpejt për fletën e votimit për këshillin bashkiak të Bashkisë Tiranë. Keni disa kopje. Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Të dyja propozimet e Komisionerit janë propozime, të cilat nuk mbështeten në Kodin Zgjedhor dhe si rrjedhojë sipas pretendimit tonë këto propozime nuk duhen pranuar kështu siç janë. Së pari, Komisioneri ka një precedent shumë të mirë në hartimin e listave për zgjedhjet...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Celibashi: Ndjesë, por po diskutojmë fletën e votimit për këshillin e bashkisë Tiranë.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Në vitin 2021, pas një debati shumë të gjatë në lidhje me fletën e votimit, u vendos një standard, megjithëse kishte kundërshtimin tonë, u vendos standardi. Kemi pasur dy koalicione në atë fletë votimi: Koalicioni PD-AN, me parti drejtuese Partinë Demokratike të Shqipërisë, dhe Koalicioni ABEOK, në mos gaboj, me zotin Kujtim Gjuzi drejtues. Në këtë rast, Komisioneri, KAS-i e të gjitha vendimmarrjet me radhë, fleta e votimit doli që emri i kryetarit të partisë drejtuese të koalicionit, siç jua kam përmendur edhe në emel-iet që kam shkëmbyer me administratën e KQZ-së, ishte përcaktuar edhe emri i kryetarit të partisë drejtuese të koalicionit. Konkretisht ka qenë zoti Lulzim Basha në fletën e votimit, ka qenë edhe zoti Kujtim Gjuzi për koalicionin ABEOK, në mos gaboj. Ne jua kemi dërguar, i nderuar zoti Komisioner, edhe fletën e votimit të vitit 2021 dhe Komisioneri ka vlerësuar që përsëri të na sjellë një propozim ku dy koalicionet, të cilat rezultojnë në fletën e votimit janë pa emrin e kryetarit të partisë që drejton koalicionin. Kjo është e papranueshme, krijon konfuzion në fletën e votimit, nuk përcaktohen qartë identiteti dhe rregullat e nenit 98 të Kodit Zgjedhor, i cili flet qartësisht për përmbajtjen e fletës së votimit. Pika 3. “Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë, vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit, i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësit”. Kjo është pika 3 e nenit 98, që Komisioneri në vitin 2021 e ka respektuar. Shkojmë te nenin 65, pika 3. Po e lexoj në mënyrë literale dispozitën e nenit, megjithëse Komisioneri është në dijeni, por

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

unë për të mos bërë gabim, dua t'i referohem në mënyrë literale kësaj dispozite. Kjo dispozitë referon: “Në momentin e regjistrimit koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevoja të zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton nga subjektet zgjedhore, përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit, detyrimet reciproke midis tyre, rregullohen nga marrëveshja e koalicionit”. Tani, kemi këtë marrëveshjen këtu që Komisioneri është në dijeni, që është kërkesa drejtuar Komisionerit për regjistrimin e subjekteve të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Në pikën 3 të kësaj marrëveshjeje thuhet që partia udhëheqëse e koalicionit sipas parashikimeve të nenit 65 e vijues të Kodit Zgjedhor është Partia e Lirisë. Kjo marrëveshje është pranuar nga ana e Komisionerit dhe në bazë të saj është regjistruar edhe Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Marrëveshje të ngjashme ka edhe subjekti tjetër, Aleanca Liberale e Djathtë, ku drejtuese e koalicionit është Partia Balli Kombëtar Demokrat, në mos gabo. Sipas këtyre përcaktimeve, në fletën e votimit duhet të jetë patjetër në mënyrë shteruese dhe e identifikuar qartë emri i kryetarit të partisë që drejton koalicionin. Propozimi i Komisionerit për ta lënë këtë fletë votimi pa përcaktuar emrin qartë se kush është kryetari i partisë që drejton koalicionin, është në cenim të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe krijon një konfuzion të zgjedhësit për të identifikuar se cili subjekt është dhe çfarë përfaqëson. Për t’jua bërë më të qartë, zoti Komisioner, kryetari i partisë drejtuese të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” është zoti Ilir Meta, që është në këtë foto këtu. Ky zotëri ku është?


(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me printime me ngjyra dhe me faqe *facebook*-u eci unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të dëgjova me shumë vëmendje.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Celibashi: Zoti Kaziaj, të lutem, ta lëmë kolegun të përfundojë, pastaj do të keni edhe radhën për të folur.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kur të flasë do ta dëgjoj me shumë vëmendje. Deputete e Partisë së Lirisë, ish-LSI-së, me logon e Partisë Demokratike. Kandidatë që janë të koalicionit “Bashkë Fitojmë” me logon e Partisë Demokratike. Në qoftë se Komisioneri do të tolerojë më këto shfaqje dhe ky veprim që ka bërë që ky koalicion del pa emër drejtuesi në fletën e votimit, është qëllim vetëm për të konfuzuar zgjedhësit. Në qoftë se Komisioneri do të tolerojë këtë padrejtësi dhe do të vazhdojë të ecë në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, atëherë, zoti Komisioner, ne mendojmë që kjo nuk i shërben procesit zgjedhor dhe i vëmë minat procesit zgjedhor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E di unë çfarë ka sens.

Z. I. Celibashi: Zoti Sefa, të lutem, me qetësi.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Zoti Komisioner, në lidhje me propozimin për përmbajtjen e fletës dhe për konfigurimin jemi dakord me specimenin nr.3, por duhet patjetër të përcaktohet emri i kryetarit të partisë drejtuese të koalicionit, në mënyrë kategorike. Gjynah, zoti Roshi, ka 20 vjet kryetar partie, tani t’i heqim emrin nga partia? Zoti Meta ka 20 vjet kryetar partie, nuk hiqen emrat kaq kollaj. Ndaj mendoj që çdokush duhet të jetë krenar për drejtuesin e partisë dhe ai duhet të ketë emrin në fletën e votimit. Nuk kemi pse të bëjmë diskutime me fshehje emrash dhe diskutime se kush e drejton çfarë dhe kush përfaqëson çfarë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Ngritët edhe një çështje që lidhet me përdorimin e logos, por nuk kemi një shqyrtim të saj në këtë moment. Jemi te fleta e votimit.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Duke mos identifikuar kryetarin e subjektit që drejton koalicionin, krijohet konfuzion dhe provat janë që kemi një muaj aktivitet politik, mos më shumë, që personat që nuk përfaqësojnë Partinë Demokratike dalin me simbolet dhe me logon e Partisë Demokratike. Fakti që në fletën e votimit, me propozim të Komisionerit, nuk shkruhet emri i kryetarit të subjektit që drejton koalicionin, i shërben këtij konfuzioni të mëtejshëm. Kjo ishte qëllimi.

Z. I. Celibashi: E kuptova. Përfaqësuesi i Koalicionit “Bashkë Fitojmë”.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së dhe BF: Zoti Komisioner, këto janë çështje të shteruara për të cilat është folur më shumë se një herë. Zotëria flet gjithmonë në emër të të tretëve, pa pasur asnjë lloj legjitimiteti. Ia keni thënë ju, ia ka thënë KAS-i, ia ka thënë Kolegji dhe vazhdojnë këtu me skena të natyrës së “Portokallisë” ose të ndonjë emisioni tjetër të sarkazmës, duke bërë interesat e një subjekti tjetër, subjekt i cili ka përfaqësuesin ligjor, që i mbron të drejtat dhe i sheh edhe detyrimet që ka kundrejt këtij institucioni. Përdorimi i një gjuhe denigruese, e një gjuhe fyese kundrejt jush, kundrejt këtij institucioni, kundrejt administratës së këtij institucioni, që punon ditë natë në këtë institucion, nga ana e kolegut parafolës edhe ditën e djeshme nëpërmjet email-eve zyrtare, një gjuhë urdhëruese sikur ju me qenë nëpunës ose vartës të kolegut Sefa. Kjo është totalisht e papranueshme dhe merr kohë të panevojshme, ndërkohë na heq nga ajo që është fokusi kryesor për t’u dhënë votuesve shqiptarë zgjedhje dhe fletë votimi sa më të qartë, që të mos keqorientohen dhe të shprehin vullnetin e tyre të lirë, të pacenueshëm me votë. Që vjen me foto, që

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*


vjen me video duke denoncuar mekanizmat ligjorë. Ligjvënësi i ka vënë shumë të qartë. Në qoftë se ai pretendon se ka pasur një shkelje të një dispozite të Kodit Zgjedhor apo të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, është i lirë ta denoncojë pranë jush, ta merrni në shqyrtim, të jepni vendimmarrje, ta ankimojë atë dhe të ndjekë gjithë iterin ligjor që parashikon ligjvënësi. Të vish e të bësh skena të tilla me thënë dua emrin e këtij, dua logon e këtij, të hiqet kjo, urgjentisht të bëhet kjo, më duket pak gjuhë jo e përshtatshme për këtë komision, jo e përshtatshme për ju si përfaqësues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Më duket totalisht dalje nga thelbi dhe nga interesi kryesor që kanë qytetarët dhe subjektet politike që na kanë vënë në këto pozicione për të mbrojtur të drejtat e tyre. Faleminderit!

Z. I. Sefa: Zoti Komisioner, e dëgjova me shumë vëmendje përfaqësuesin e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, por një gjë nuk dëgjova. nuk do që të vendoset emri i Ilir Metës në fletën e votimit? Këtë nuk e kuptova, do apo nuk do? Në qoftë se nuk do, të na thotë arsyen përse nuk do. Kaq, kjo është arsyeja e vetme.

Z. I. Celibashi: Të vendosim pak rend në marrjen e fjalës. Po, përfaqësuesi i koalicionit.

Z. A. Kaziaj: Unë sapo thashë, i nderuar, zoti Komisioner, që ligjvënësi e ka parashikuar shumë qartë se duhet apo nuk duhet të vendoset emri i një kryetari të subjektit politik në fletën e votimit. Këtë gjë e tha edhe me gojën e vetë Sefa, kështu që më bën pyetjen retorike që e ka përgjigjen brenda. Ju e keni pasur gjithmonë si praktikë tuajën, por duke qenë që është i ri në këtë Komision, zoti Sefa merr praktikën tuaj sikur ka lindur KQZ-ja në vitin 2021. KQZ-ja nuk ka lindur në vitin 2021. Në qoftë se interesat e tij kanë qenë të tilla që t’i referohet vitit 2021, dakord!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Është e drejta e tij, por për shkak të memories së pakët që ka, KQZ-ja ka vite me radhë që merret me këto dhe ka praktika të konsoliduara lidhur me një fletë votimi, dhe me specimenet që duhet të ketë fleta e votimit, ashtu si ligjvënësi e ka parashikuar shumë qartë. Faleminderit!


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesja e Partisë Lëvizja Bashkë.

Përfaqësuesja e Partisë Lëvizja Bashkë: Faleminderit, zoti Komisioner! Për sa u përket dy fletëve të votimit për këshillin bashkiak, duke u bazuar në dy kriteret kryesore që janë: shorti dhe të dhënat ose saktësia e të dhënave të këtyre subjekteve, nuk kemi ndonjë problem për sa i përket çështjes së shortit, as specimenit 3, por konkretisht specimenit 1, që do t'i kërkonim Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që saktësia e të dhënave të subjektit "Lëvizja Bashkë", në qoftë se do të përdoret ky specimen, të jenë më të sakta, siç është emri i kryetarit, mbiemri në këtë rast, që duhet shënuar i saktë dhe emri i subjektit "Lëvizja Bashkë", në qoftë se i qëndrojmë statutit dhe të dhënave që ne kemi depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Faleminderit, zoti kryetar! Në lidhje me projektaktin për fletët e votimit për kryetar për qarkun e Bashkisë Tiranë, por edhe për kandidatët për këshillin e bashkisë, ne si subjekt zgjedhor do t'i sugjeronim Komisionerit të merrte në konsideratë specimenin nr.1, duke rregulluar edhe të dhënat e subjektit tonë, nr.12, Drejtësi, Integrim, Unitet, sepse nuk është subjekt zgjedhor i regjistruar në këtë institucion, por është Partia për Drejtësi, Integrim dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Unitet. Do të ishim për këtë fletë votimi me këtë pamje, por të kishte mundësi të bëhet më e qartë, shkrimi të hapej më qartë, që të mos kishte konfondim nga zgjedhësit, që do të votojnë në 14 maj. Duke pasur edhe numrin e madh të kandidatëve, kjo është edhe fleta që mund të sjellë konfuzion te zgjedhësit, duhet të ishte më e qartë, duke bërë ndryshimet siç tha edhe kolegja, por pa harruar edhe shënimet e sakta të subjekteve zgjedhore. Për sa i përket fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, flasim më vonë.

Z. I. Celibashi: Fjalën e ka përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kam një pyetje për administratën e KQZ-së dhe për Sekretarin e Përgjithshëm në lidhje me fletën e votimit për këshillin bashkiak. Ka ndonjëherë në historinë e KQZ-së që në fletën e votimit për këshillin bashkiak ose për zgjedhjet e përgjithshme kur kemi të bëjmë me koalicion, të mos jetë vendosur emri i kryetarit? Ka ndonjë precedent të kryetarit të partisë drejtuese të koalicionit? A ekziston ndonjë precedent i tillë? Unë vërtet e kam memorien e shkurtër, siç tha edhe kolegu, por besoj që me sa informacion që kam, nuk ka një precedent të tillë. Sa për informacion, me ndryshimin e Kodit në vitin 2020, ka ndryshuar edhe strukturimi i KQZ-së. Komisioneri me emërimin e tij dhe me marrjen e detyrës ka praktika shumë herë më të ndryshme se ish-Komisioni i vjetër Qendror i Zgjedhjeve. Ka bërë praktikën e tij që në momentin kur ka ardhur në këtë institucion. Zgjedhjet e organizuara nga Komisioneri në vitin 2021 e tregojnë qartë këtë, zgjedhjet e pjesshme të vitit 2022 e tregojnë qartë, këto janë zgjedhjet e treta. Pyetja është specifike: ka ndodhur ndonjëherë që në fletën e votimit të mos jetë përcaktuar emri i kryetarit të partisë drejtuese të koalicionit? Ka rast specifik ndonjëherë?

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Celibashi: Ju mund ta merrni informacionin e mund ta konsultoni atë nëse keni interes për këtë, me siguri nuk mund t'i referohemi memories biologjike të gjithsecilit prej nesh, ka dokumentacion për këtë. Duhet marrë dokumentacioni, do konsultuar, nëse keni nevojë për këtë gjë. Gjithsecili prej nesh është i qartë. Nëse e kërkon të administrohet ky si dokumentacion ose të njiheni, kjo është një çështje tjetër.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Nuk kërkoj të administrohet asnjë dokumentacion. Te precedenti i këtij Komisioni është që vendoset emri. Precedenti i vendosur nga ju si Komisioner, por edhe nga KQZ-ja më përpara është që vendoset emri i kryetarit të partisë drejtuese të koalicionit. Ka qenë historikisht kështu. Ky është precedenti i parë që ndodh që vjen një propozim pa emrin e kryetarit të partisë drejtuese të koalicionit. Ky është precedenti i parë në këtë Komision Qendror të Zgjedhjeve.

Z. I. Celibashi: Kemi diskutime të tjera? Përfaqësuesi i Partisë Socialiste.

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Faleminderit! Është bërë *deja vu* kjo puna e fletës. Në çdo palë zgjedhje kemi 15 vjet që gjithmonë bëhet debat dhe në fund e vendos KQZ-ja, Komisioneri dhe të gjithë shkojnë e votojnë. Kur ka debat, duhet t'i drejtohem ligjit, që të gjejmë zgjidhje, përderisa nuk biem dakord. Rregullisht duhet të binin dakord të gjitha palët, meqenëse zgjedhjet janë garë midis palëve, palët përcaktojnë edhe armët me të cilat do të dalin në garë dhe fleta, për mendimin tim, duhet të ishte edhe një konsensus midis nesh. Në qoftë se biem 100% dakord, ju duhet të bënit vetëm miratimin, sepse tek e fundit, zgjedhjet për partitë që garojnë janë, ditën e diel. Pra, duket një gjë e thjeshtë si fletë votimi, po e gjithë kjo fushatë bëhet vetëm për këtë fletën e votimit. Pra, ditën e diel, gjithë atë fushatë, të gjitha

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

subjektet e materializojnë duke çuar zgjedhësit për t'u paraqitur në qendrat e votimit dhe për të votuar në këtë fletë votimi. Meqenëse s'ka konsensus, atëherë unë them t'i referohemi ligjit dhe ligji besoj se është i qartë në këtë pjesë, për arsye se ka pasur debat në vite dhe ligjvënësi është kujdesur që ta sqarojë në mënyrë të detajuar, për sa i përket përmbajtjes të fletës së votimit. Neni 98 merret vetëm me mënyrën se si duhet të ndërtohet fleta e votimit dhe elementet që duhet të përmbajë fleta e votimit. Ne i kemi propozuar një variant KQZ-së duke lexuar ligjin, aq sa ne e kuptojmë dhe e interpretojmë, ku pika 3 thotë: Përmbajtja e fletës së votimit. Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme të shortit. Përbri emrit të partisë vendoset sigla. Pra, përbri emrit të partisë vendoset sigla, dhe ne në variantin 3, po ta shikoni, kemi emrin e partisë, emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit. Përbri emrit vendoset sigla. (Hape vetëm një rënë që ta shohë edhe media.) Përbri emrit vendoset sigla e partisë, që është vendosur sigla. Vendosen shkronjat nistore, janë edhe shkronjat nistore në krah të siglës, si dhe numri dhe përbri edhe emri i kryetarit të partisë, i cili është në krahun e djathtë, si dhe kutia ku do të vendosin zgjedhësit; për sa i përket anës formale të fletës dhe mënyrës se si do të renditen subjektet. Në pikën 4, për sa i përket fletës së votimit, jepet edhe mënyra se si do të ndërtohet kjo fletë për sa i përket informacionit që duhet të paraqesë dhe konfigurimit, ku thuhet: “Duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejte i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i kuptueshëm për zgjedhësit, ta ketë të lehtë orientimin dhe të mos konfondohen zgjedhësit.” Për sa i përket debatit që po bëhet midis dy subjekteve zgjedhore, unë do të isha që të pranohej kjo fletë që ka paraqitur Komisioneri, në qoftë se ne nuk do të kishim debat në këtë sallë. Pra, nëse nuk do të kishte konfondim. Këtu është fleta. Po flasim për koalicionin “Bashkë Fitojmë”, në qoftë se nuk do të kishte konfondim, se në rastin konkret subjekti Partia Demokratike

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

thotë që mosvendosja e subjektit të emrit të drejtuesit të koalicionit në fletën e votimit krijon një konfondim. Kjo është prova të cilën dispozita, neni 98 nuk e lejon, ku thuhet, se në qoftë se konfondohen dhe ka paqartësi, atëherë ne duhet të shikojmë mënyrën se si ta sqarojmë këtë paqartësi. Cila është? Vendosja e emrit të drejtuesit të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Mund të thuhet dhe përderisa po e kuptoj, pavarësisht se nuk u përgjigj në mënyrë direkte përfaqësuesi i koalicionit, por nuk thuhet arsyeja pse nuk vendoset emri. Në qoftë se nga kërkuesi, Partia Demokratike, e kemi arsyen dhe arsyeja besoj se gjen pasqyrim në nenin 98, që duke pretenduar se krijohet një konfuzion, në rastin konkret nga subjekti “Bashkë Fitojmë” nuk kemi arsye sepse të mos vendoset. Çfarë është? Një orientim më shumë. Pra, këtu dalim bëjmë fushatë, kemi sjellë dokumente në KQZ, se kush e drejton dhe nuk e pasqyrojmë. Në qoftë se do të ishim pa debat, ne si Parti Socialiste nuk do ta diskutonim fare këtë fakt. Përderisa këtu është një shqetësim i ngritur dhe krijohet një konfuzion, atëherë jeni ju si Komisioner që vendosni, që s’duhet të lejoni që ky konfuzion të ndodhë për sa i përket informacionit që pasqyrohet në fletën e votimit. Pra, përfundimisht do të thosha që jemi me variantin e tretë dhe të vendosni duke iu referuar nenit 98 që të ftoni subjektin “Bashkë Fitojmë” të paraqesë emrin e kryetarit që e drejton këtë koalicion, pavarësisht se për ne është dokumentacioni që ju keni depozituar në momentin e regjistrimit dhe del fare qartë se cili është drejtuesi i këtij koalicioni. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Pra, ju jeni për këtë versionin që siglat të jenë përbri numrit rendor, për këtë version. Përfaqësuesi i koalicionit.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së dhe BF: Zoti Komisioner, qëndrimet e njëjta tashmë të njohura jo vetëm në këtë seancë po edhe nga veprimet e mosveprimet e dy

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

subjekteve që folëm me parë, tregojnë haptazi në mënyrë të heshtur, të themi, atë që është marrëveshja e tyre dhe qëndrimet e tyre për të arritur objektivat e tyre të përbashkët. Nuk ka lidhje me mosqëndrimin tim. Në një pyetje të bërë nga kolegu Sefa, unë thashë që ligji është shumë i qartë, le të aplikohet ligji, nuk dua asgjë më shumë se aplikimi i ligjit. Mbase Salianji nuk e kishte kuptuar, e lexove vet dispozitën, koleg. Për sa i përket pjesës së fletës së votimit për kandidatët për këshilltarë të bashkisë, e filloi nga 3-shi kolegu, ndërkohë që kemi 1-shin para se të shkojmë te 3-shi, të paktën nga ato që janë modelet e sjella nga ju, dhe nuk kuptoj, sepse paska mangësi 1-shi, që të shkojmë te 3-shi dhe nuk u përputhka me atë që është parashikimi i ligjvënësit në pikën 3 të nenit 98. Unë besoj se janë të gjitha elementet: është numri, është logoja, është subjekti, duhet jetë normalisht, edhe emri i përfaqësuesit, janë shkronjat nistore dhe kutia përkatëse për shënimin e votuesit. Normalisht mund të bëhet pak më e madhe, në sensin e gjatësisë së fletës, në mënyrë që kutia të jetë pak më e madhe, mund të bëhet, le të themi, me bold e gjitha pjesa e specifikimeve të çdo subjekti. Kështu që mendojmë që vënia në dukje e kryetarit të një partie politike në vetvete, nuk do të thotë që zgjedhjet i fiton kryetari i partisë politike, po është forca politike ajo, është platforma politike ajo, dhe është i gjithë programi që u ofrohet zgjedhësve, ajo që duhet të fitojë dhe të dalë, të themi, në pah të votuesit, në mënyrë që këta të fundit të mos keqorientohen. Kështu që mendoj që specifikisht është specimeni nr. 1 që duhet të përzgjidhet për t'u votuar nga ana juaj, për t'u konfirmuar. Kështu që jemi të kësaj ideje dhe të këtij qëndrimi. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po edhe një herë përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Zoti Komisioner, çështja është që në të dyja versionet e specimenit të fletës së votimit, ajo që konstatova është që ka, le të themi,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

mosbarazi armësh. Kemi një pjesë të subjekteve politike, që janë parti politike që konkurrojnë dhe janë të mbështetura ose me të cilat pasqyrohet emri i kryetarit dhe kemi dy koalicionet në të cilat nuk pasqyrohet emri i kryetarit. Këtu nuk ka lidhje, domethënë çështja nuk shtrohet në lidhje me Koalicionin “Bashkë Fitojmë”, çështja është në lidhje me barazinë e armëve në një fletë votimi, që të kthehemi te kjo çështja e interesit të ligjshëm. Për aq kohë sa ne kemi fletë votimi, kemi interes të ligjshëm ta adresojmë mënyrën si formulohet fleta, por në një fletë votimi nuk mund të kemi të dhëna të plota për një pjesë të subjekteve dhe pastaj të dhëna të mangëta për pjesën tjetër të subjekteve. Minimalisht, kjo do të ishte në dëm të subjekteve me të dhëna të mangëta, sepse do t’u krijonte atyre kushtet e pabarazisë së armëve në krahasim me subjektet e tjera që kandidojnë me të dhëna të plota.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Dakord.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Problemi, zoti Komisioner, se nuk kam dëshirë edhe të reagoj ndaj kolegut, se kjo punë vajti si e tejzgjatur tanimë, po kur lexon ligjin dhe kur ka dy njerëz që e lexojnë ligjin në të njëjtën formë, hidhen akuza bashkëpunimi, ndërkohë që kanë tetë vjet që e kanë integruar Shqipërinë bashkë, kanë qenë bashkë në koalicione të përhershme, kanë qeverisur bashkë edhe ne jemi ata pastaj që jemi në koalicion me Partinë Socialiste. Duhet të shikojnë nga vetja një herë, pavarësisht se qëndrimi im është që po të ndryshosh emrin, prapë nuk më ndryshon dot historinë.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Unë një pyetje kam për ju përfaqësuesit e Partisë Demokratike. Vendosja ose mosvendosja e emrit të kryetarit të Partisë së Lirisë, zotit Ilir Meta, në fletën e votimit përbri emrit të koalicionit, çfarë interesi ka në lidhje me qartësinë dhe moskonfondimin e votuesve, në raport me subjektin tuaj?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ka rëndësi thelbësore në respektimin e ligjit. Përveç ligjit ka edhe precedentë ky komision: ose Komisioneri nuk e ka zbatuar ligjin në 2021-shin, ose nuk po e zbaton tani. Dy variante janë. Ose atëherë nuk e ka zbatuar ligjin, sipas parashikimeve ligjore, ose nuk po e zbaton tani. Dhe e dyta jua tregova.


Z. I. Celibashi: Jo, tej kësaj, se kjo është një çështje tjetër.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Unë jua tregova, ky është interesi që kishim.

Z. I. Celibashi: Po, pra dakord edhe unë e pashë, po tej kësaj.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Tej kësaj zgjedhësi duhet ta dijë që ky Koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka partitë politike: Partinë e Lirisë, Partinë Demokristiane, drejtuar nga Nard Ndoka dhe Partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, që drejtohet nga zoti Vangjel Dule dhe nuk ka në asnjë moment një parti me këtë logo. Fakti që në fletën e votimit që realisht, ligjërisht dhe me dokumentacionin e paraqitur koalicioni drejtohet nga Partia e Lirisë me kryetar, Ilir Metën duhet të specifikohet në fletën e votimit, që këtë koalicion e drejton Partia e Lirisë dhe Ilir Meta dhe askush tjetër. Kjo është për në respektim të ligjit dhe për t’i vënë të gjitha subjektet në kushte të barabarta, të mos lemë ca subjekte të paidentifikuara, pa qasje dhe në konceptin që nuk e dinë se kush është drejtuesi real i koalicionit për të krijuar një kakofoni politike dhe ka ca subjekte që, sipas detyrimeve ligjore, kanë përcaktuar të gjithë të dhënat që kërkon përmbajtja e fletës së votimit. Është pika 3 dhe përmbajtja e fletës së votimit tregon qartësisht faktin që duhet të jetë patjetër emri i kryetarit, edhe subjekt zgjedhor, thotë, dhe subjekt zgjedhor është dhe koalicioni.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Celibashi: Më fal, ju keni gjithë të drejtën të mos përgjigjeni ose të përgjigjeni si e çmoni ju. Pyetja ime ishte e qartë: çfarë interesi të ligjshëm keni ju si subjekt zgjedhor, në lidhje me faktin e të qenurit në fletën e votimit të kryetarit të partisë udhëheqëse? Të lutem, ta mbaroj, të lutem, se unë ju dëgjova dhe s'ju ndërpreva asnjëherë!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Dakord, më fal!

Z. I. Celibashi: Qenia ose mosqenia e emrit të kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit në fletën e votimit. Ka ndonjë argument nga ana juaj veç atij që ju thatë deri tani, pra tjetër, veç atij që ju thatë, ka argument tjetër? Po ose jo, nëse nuk ka argument tjetër... jo, jo veç atij që thatë deri tani?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Argumenti që thashë edhe më përpara...


Z. I. Celibashi: Jo, jo veç atij që the më përpara, ke argument tjetër?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po nuk është çështje argumentesh, zbatueshmëria e ligjit nuk ka nevojë për argumente. O është ligjore, o nuk është.

Z. I. Celibashi: Po, pra përveç zbatueshmërisë së ligjit, veç këtij argumenti s'ke tjetër?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Komisioneri...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Celibashi: Të lutem, zoti Sefa, nuk dua që..., ja vetëm një sekondë. Unë ju dëgjova me vëmendje, veç argumentit që ju thatë deri tani, në rregull, që mos të kalojmë në përsëritje, keni argument tjetër veç këtij argumenti, po ose jo? Nëse po, vazhdoni, nëse jo nuk ka, kaq. Keni argument tjetër veç atij që thatë deri tani?

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Atëherë zoti Komisioner, se duhet të kthehemi pak në historinë e 4-5 muajve të fundit. Kjo çështja e marrëveshjes dhe koalicionit ndërmjet Partisë Lirisë...

Z. I. Celibashi: Ndjesë, që ju ndërpres, veç çfarë keni thënë deri tani, keni argumente të tjera shtesë?

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Zoti Komisioner, se dua ta kuptoj pyetjen, kur thoni argumente të tjera shtesë..

Z. I. Celibashi: Domethënë, ka ndonjë argument tjetër veç atyre çfarë listuat deri tani, veç atyre që listuat, që të mos kalojmë në përsëritje? Pyetja ime është shumë e thjeshtë: veç atyre që thatë deri tani, keni argument shtesë tjetër?

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Dy argumente kemi në lidhje me këtë gjë: E para punës t'i...

Z. I. Celibashi: Jo. shtesë shtesë, veç atyre që thatë.

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Mund t'i rendis këto të dyja që kemi thënë deri tani.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Celibashi: Unë kam vetëm një pyetje. Nëse jo, thuaj nuk i përgjigjem kësaj pyetje dhe dakord.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Sa argumente do Komisioneri që të bindet, një numër. Një pyetje kam unë: sa argumente do Komisioneri: 10 a 15..

Z. I. Celibashi: Nuk ka rëndësi se sa kërkoj unë, ju duhet ta respektoni kërkesën time, unë kam vetëm një pyetje që kërkon një përgjigje të thjeshtë.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Përgjigjja është: për të zbatuar ligjin, ashtu siç e kërkon ligji, në disa raste nuk ka nevojë fare për argument, sepse ju duhet të jeni garantuesi i subjekteve zgjedhore, që të garojnë në mënyrë të barabartë, në kushte të barabarta. Nuk mundet një subjekt ta lemë ...


Z. I. Celibashi: O Indrit, të lutem, tani.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Argumenti ynë është që kemi një subjekt, i cili nuk ka asnjë marrëveshje me Partinë Demokratike dhe sot në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve del pa emër.

Z. I. Celibashi: Të lutem, kjo është hera e shtatë ose e tetë që e përsërit. Domethënë, të lutem, unë kam vetëm një pyetje të thjeshtë dhe ju më bëni një përgjigje të thjeshtë.
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Veç këtij, nuk ke argument tjetër, këtij që the së fundi? Veç këtyre, keni të tretë? Nuk keni të tretë. Këto dy argumente keni? Në rregull, kaq më duhet.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra nuk keni tjetër veç kësaj? Dakord. E kuptova. Diskutime të tjera besoj se nuk kemi në lidhje me këtë çështje. Dakord. Atëherë, në vlerësimin tim, në lidhje me këtë çështje ajo që përcakton ligji dhe qartësisht do të duhet në interpretimin rigoroz të ligjit, në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit, principi kryesor ka të bëjë me qartësinë e votuesve për të bërë zgjedhjen e tyre. E para. Natyrisht, kjo duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, qartësia e përmbajtjes së fletës së votimit dhe ajo që e bën legjitime kërkesën e çdo subjekti zgjedhor, në lidhje me diskutimin për përmbajtjen e fletës së votimit janë dy momente: qartësia e elementeve përbërëse të shkrimit të subjektit në fletën votimit, për subjektin i cili merr pjesë në garë. Pra, nëse të dhënat e tij janë ashtu sikur do të duhet të jenë dhe të qarta për votuesin. E dyta, për të verifikuar nëse të dhënat e shkrimit të një subjekti tjetër janë të tilla, që mund të konfundojnë subjektin për të cilin ka interes. Këto dy parime do të duhet të respektohen. Më vjen keq ta them, po në diskutimet që keni bërë, përjashtoj diskutimin e përfaqësueses së subjektit zgjedhor “Lëvizja bashkë”, e cila i qëndroi strikt dhe vetëm interesit të saj të ligjshëm, për të dhënat që lidhen me subjektin që ajo përfaqëson, diskutimet tuaja ishin se si duhet të jetë shkrimi për kundërshtarin.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Nuk thamë ndrysho shkrimin, thamë respekto ligjin, vendos emrin, siç ke bërë në 32 vite demokraci dhe zgjedhje në Republikën e Shqipërisë. Në 32 vite është vendosur emri, është precedenti i parë dhe shumë i rrezikshëm, Komisioner, edhe një herë, është precedenti i parë dhe shumë i rrezikshëm.

Z. I. Celibashi: Të lutem, ta rregullosh tonin kur komunikon me Komisionerin.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po flas në mënyrë të kulturuar dhe me shumë edukatë. Po të them është precedenti i parë dhe shumë i rrezikshëm që po krijoni. Që nga momenti që e keni filluar këtë proces zgjedhor, që me regjistrimin e Partisë Demokratike e të gjitha me radhë po merrni veprime që cenojnë rëndë dhe shumë rëndë procesin zgjedhor.

Z. I. Celibashi: Ky është presion i hapur.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Komisioner, unë nuk bëj presion.

Z. I. Celibashi: Do të më lësh të flas unë, se unë nuk ju ndërpres asnjëherë, të lutem! Mos u trego i paedukatë.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Unë i referohem ligjit, unë nuk bëj presion.

Z. I. Celibashi: Nëse do të flasësh, kërko dhe fol sa të duash, kur flas unë mos më ndërprit, të lutem!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo, se the që bëra presion, unë nuk bëj presion.

Z. I. Celibashi: Po çfarë është kjo mënyrë e të diskutuarit? Jep argumentet e tua, vlerësoji si i vlerëson ti dhe më lër mua të jap gjykimin tim. Nuk më imponohesh dot me çdo lloj mënyre. Të jetë e qartë, nëse do të flasësh prapë, urdhëro, ke të drejtën fol!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Unë nuk i imponohem njeriu, nuk i bëj presion njeriu, megjithëse ky institucion mund të ketë memorie nga e kaluara se si bëhej presion dhe si mbaheshin konferencat e shtypit, por unë nuk e kam këtë praktikë. E para. E dyta, po të them precedenti që ky Komision ka në 32 vjet të bërjes së zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë është rasti i parë që po tentohet të kalohet një fletë votimi pa emrin e drejtuesit të partisë. Është rasti i parë. Nuk ka ndodhur kurrë, dhe po marr përsëri precedentin e vitit 2021 kur ky Komisioner ka qenë në detyrë. O ka shkelur ligjin atëherë Komisioneri, o po e shkel tani. Dy variante janë.

Z. I. Celibashi: Kjo është hera e 12-të që e ke përmendur këtë argument. Nëse ke nevojë për një herë të 13-të ...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Vazhdoni me vendimmarrjen...

Z. I. Celibashi: Unë isha duke vendosur dhe arsyetuar po... atëherë, për t'u rikthyer atje ku ju ndërpreva. Kodi Zgjedhor e ka të përcaktuar qartë dhe në interesin e ligjshëm dhe aspektin rregullator në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit. Sikurse dhe ju e cituat dispozitën përkatëse të Kodit Zgjedhor, Kodi Zgjedhor ka përcaktim në lidhje me vendosjen e emrit të kryetarit të partisë në fletën e votimit. Nuk ka asnjë rregullim dhe asnjë urdhërim nga ana Kodit Zgjedhor në lidhje me vendosjen e emrit të kryetarit të koalicionit. Çfarë ka ndodhur në të shkuarën?! Vendosja e emrit të kryetarit të koalicionit në fletën e votimit, ka qenë zgjedhje e koalicionit vet, bazuar në një marrëveshje që kanë pasur kryetarët ose partitë e koalicionit. Marrëveshja mbi partitë që krijojnë një koalicion ka hyrë si koncept vetëm në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, kur është folur për partinë udhëheqëse dhe për marrjet e përgjegjësisë në emër të koalicionit nga një parti. Para


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

ndryshimeve të Kodit Zgjedhor nuk ka pasur fare rregullim në lidhje me aspektin e marrëveshjes së partive që konkurrojnë në një koalicion. Megjithatë, në këto raste kanë qenë vendosur emri i kryetarit të një partie bazuar, në një zgjidhje të vullnetit të vetë subjektit zgjedhor koalicionit. Kjo gjë do të thotë që edhe në precedentin tim, meqenëse, iu referuat disa herë zoti Sefa, vendosja e emrit të kryetarit të partisë së koalicionit ka qenë kërkesë e qartë e subjektit zgjedhor, koalicionit për të vendosur një emër të njërit prej kryetarëve të partive të koalicionit në fletën e votimit. Për të kuptuar që nuk ka një domosdoshmëri, jo vetëm për faktin që ligji këtë nuk e thotë. Ligji thotë të kryetarit të partisë të vendoset. Ka logjikë, dhe ka sens, sepse në rastin e koalicionit janë së paku dy parti që marrin pjesë, dhe do të duhet konsensusi i këtyre dy partive për të vendosur mbi të gjithë elementet identifikues të këtij subjekti në fletën e votimit. Ngelet në vlerësimin e tyre legjitimiteti i interesit për përmbajtjen e fletës së votimit për këtë element. Në mënyrë të padiskutueshme është kështu. Ne nuk mund të vendosim emra, apo të dhëna që shkojnë tej parashikimeve të ligjit dhe tej vullnetit të partive apo të subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në koalicion, sa kohë, që nuk ka një kundërshti bazuar në mos konfondimin (ngatërrimin) e të dhënave tek zgjedhësit të subjekteve zgjedhorë. Edhe tej kësaj është tërësisht interesi i ligjshëm i atij që lidhet me emrin, apo dhe të dhënat e tjera të subjektit, ndaj thashë që ... me përjashtim të një përfaqësuesi, kjo ishte kuptuar shumë qartë më vjen keq për pjesën tjetër që e drejtuan debatin në atë mënyrë, por gjithsesi. Ndaj në tërësi për diskutimin që u bë dhe për mënyrën organizimit dhe paraqitjes së subjekteve në fletën e votimit për kandidatë për anëtarë të këshillit, edhe pse në një lloj mënyre. duhet ta pranojmë që të gjithë ne kemi gjykime subjektive që lidhen edhe me aspektin estetik të fletës së votimit edhe pse do të duhet t'i qëndrojmë thjesht dhe strikt aspektit informativ të saj për të kuptuar, se cila përmbajtje është më e qartë nga pikëpamja informative. Natyrisht, që secili prej nesh ka pëlqimet e veta estetike. Por,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

në vlerësimin tim bazuar, thjesht dhe vetëm në qartësinë e informacionit, unë mendoj që fleta e votimit për anëtarë të këshillave bashkiakë do të jetë versioni 1 (një) me ndryshimet që lidhen me bërjen kapital të emrave të partive politike dhe të subjekteve zgjedhore, dhe të emrave të kryetarëve të partive, duke hequr numrin në pjesën e fundit. Ndërkohë do të bëjmë korrigjimet për subjektin zgjedhor “Lëvizja Bashkë” dhe për ta përfunduar, edhe PDIU, po i kemi bërë ndryshimet, i kemi reflektuar. Mund ta zmadhosh pak atë? Ky është versioni i fundit nëse nuk gaboj. Pra, ky do të jetë versioni i fundit i fletës së votimit. Të lutem, jo, këtë e vendos Komisioneri, të lutem mos më ndërprit zoti Sefa. Në lidhje me çështjen e vendosjes së emrit ose jo, në fletën e votimit të kryetarit të një prej partive përbërëse të Koalicionit “Bashkë fitojmë”, unë do t’ju jap një orë kohë për të vendosur në lidhje me këtë nëse doni ose nuk doni të jete emri. Është tërësisht çështja juaj nuk është fare çështje e ...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së dhe BF: Do të më jepni kohë mua si përfaqësues?


Z. I. Celibashi: Po ju keni legjitimitetin për të ...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së dhe BF: Unë dhashë dorëheqjen, i mori tagrat zoti Sefa që foli vetëm në interes të subjektit tim. Kështu që ta pyesim njëherë mos ka ndonjë mendim ndryshe, mos ka ndryshuar qëndrim.

Z. I. Celibashi: Kemi një orë kohë për këtë. Gjithë pjesa tjetër e fletës së votimit është me këtë përmbajtje, faleminderit.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ma delegoi mua këtë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Celibashi: Pas një orë nëse ke autorizimin për të folur.


Rifillon seanca

Ora 13:11

Z. I. Celibashi: Atëhere rifillojmë, në lidhje me plotësimin e përmbajtjes së fletës së votimit për subjekte zgjedhore, për anëtarë këshilli, kemi marrë konfirmimin dhe nga koalicioni tjetër që nuk kanë interes për të vendosur emrin e ndonjërit prej kryetarëve të partisë në fletën e votimit. Atëhere e përfundojmë edhe këtë çështje, si për rastin e Koalicionit Bashkë Fitojmë, ashtu edhe për rastin e koalicionit tjetër, nuk do të jetë emri i asnjërit prej kryetarëve të partive, përbërëse të koalicioneve respektive në fletën e votimit.

Vendimi nr. 361

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

**15.04.2023
Ora 12:08**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.


PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan CELIBASHI**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaç, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj.**
- **Parti politike: PD, PDIU, PS, BF, Lëvizja Bashkë**
- **Të tjerë: KRIIK, ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër, me përmbajtjen e fletës së votimit për kryetar dhe kërkoj gjithë mirëkuptimin tuaj në lidhje me diskutimin e çështjes së emrit të kryetarit ose jo, të koalicionit. Por edhe këtu kemi disa variante. Ky është varianti i parë fare, nëse nuk gaboj. Kemi një variant që është pa logo të partive, një variant me logo të partive dhe stilizime të tjera. Këto janë variantet. Përfaqësues të partive politike lidhur me përmbajtjen e fletës së votimit për bashkinë e Tiranës?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së dhe BF: Zoti Komisioner, ne mendojmë që praktika të ngjashme, po ashtu edhe fryma e ligjit, është pak a shumë sipas versioneve të sjella nga ana juaj tek specimeni 1 dhe 2, që parashikohen emrat e kandidatëve, emrin e subjektit politik që kandidati përfaqëson në këto zgjedhje për kryetar bashkie, dhe në krahë të vet shfaqen shkronjat nistore të tij, dhe në fund të fletës është dhe shënimi i votuesve. Kështu që, mendojmë që të gjitha praktikat e KQZ-së orientojnë dhe fryma e ligjit të themi orientojnë drejt këtyre dy

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

specimenëve. Kështu që, mendojmë se duhen të merren parasysh një nga këto 2 fletë votimi që na janë vënë në tavolinat tona. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike.


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Edhe sipas procedentit të këtij komisioni, ka një precedent me 6 mars, ku fleta për kryetar bashkie shoqërohej me siglën e partisë propozuese të saj që është varianti me nr. 3 në mos gaboj. Ne jemi me këtë variant, por duke parë dhe vendimmarrjen e fundit të Komisionerit, partitë që duan ta kenë logon le ta mbajnë, ato që s'duan le ta heqin logon.

Z. I. Celibashi: Do ju lutesha zoti Sefa, t'i kursenit ironitë sepse nëse doni ta bëni mbi bazë ironie këtë diskutum. Kjo nuk do tju nderonte ju, tani unë nuk thashë për logot thashë për emrin e kryetarit. Vazhdo, shumë faleminderit për të gjithë mirësjelljen e treguar hipokrite. Përfaqësuesi i Partisë Socialiste e ka fjalën!

Z. E. Saliqji, përfaqësuesi i PS-së: Normale, siç e thashë edhe në fillim ka debate për fletën. Unë dua ti ngelem strikt ligjit edhe në debatin e parë, ligjin diskutova pavarësisht se Komisioner ju prisnit që unë të flisja vetëm për Partinë Socialiste po ne nuk jemi këtu të flasim vetëm për subjektin tonë. Ne jemi për të folur për përmbatjen e fletës së votimit. Përmbatja e fletës së votimit referuar pikës 3, nenit 98 përsa i përket kandidatit, emrat e subjekteve thotë zgjedhore vendosen në fletët e votimit. Në këtë rast subjektet zgjedhore është kandidati sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit thotë përsëri pika 3, vendoset sigla edhe këtu besoj debati është i mbyllur. E ka caktuar shumë qartë ligji, që kandidatë janë subjektet dhe sigla është ajo, e cila duhet të vendoset përkrah emrit. Tani ne e

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

kemi thënë si subjekt politik që fushata po bëhet që Partia Demokratike të shkojë tek Partia e Lirisë por jo nëpërmjet këtij institucioni, jo nëpërmjet fletës së votimit. Pra, nuk do t'i shërbeni ju kësaj fushate. Subjektet kanë të drejtë ta bëjnë fushatën, kanë të drejtë t'i çojnë votuesit e tyre ku të duan, por jo duke përdorur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ju duhet të jeni rigoroz në zbatimin e ligjit dhe përsa i përket këtij zbatimi, për sa i përket fletës së votimit, ju duhet ta bëni mjaft të qartë se cilat janë subjektet të cilat garojnë në zgjedhje. Subjektet kanë identitet, nuk mund të fshihemi këtu pas gishtit. Identiteti përcaktohet nga emri i partisë, nga sigla edhe nga emri i kryetarit. Të fshihesh pas gishtit dhe të thuash që dua të kandidoj po nuk dua siglën do të thotë që nuk do identitetin, do të thotë që do të ngatërrosh identitet. Dua të garoj po nuk dua ta paraqes emrin e kryetarit do të thotë të fshihesh mbas gishtit. Tashmë të gjithë e dimë se kush e drejton atë koalicion dhe se kush parti është, partia e cila tashmë udhëheq koalicionin dhe partia që është e regjistruar dhe i ka dhënë jetë këtij koalicioni. Pra, është Partia e Lirisë që i dha jetë koalicionit, është Partia Demokratike që është futur në këtë koalicion nëpërmjet kësaj partie. Tani në qoftë se duam të heqim edhe logon, emrin e kryetarit të Partisë së Lirisë që për mua pas këtyre zgjedhjeve mundet, mund të kenë qëllim politik që ato votues t'i quajnë të Partisë së Lirisë dhe nëpërmjet këtij votimi...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit BF: Më fal Salianji që ndërhyjë tani, nuk do të zbresim në këto nivele. Ju sapo i thatë zotit Sefa që mos të flasë në interes të palëve të tjera. Po ashtu promovuat kolegen tjetër duke folur vetëm në interes të palës së vet, subjektit që përfaqëson. Të lutem të mbajmë një qëndrim konstant mos të vonohemi përtej asaj duke i bërë llogaritë politike një subjekti tjetër që nuk përfaqësoni.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Celibashi: Unë jam dakord me këtë qasje por nuk ju ndërpres dot edhe nuk ndërhyjë dot në narrativën tuaj.

Z. E. Salianji, përfaqësuesi i PS-së: Fleta e votimit është ajo ç'ka sjell pasojën. Sjell ata votues ditën e diel. Zgjedhësit duhet të dinë patjetër për kë duhet të votojnë. Për identitetin e asaj partie, është logo, është emri i kryetarit të partisë, është edhe emri i partisë. Të treja elementët duhet të jenë në fletën e votimit. Këtu çuditërisht në këto zgjedhje është hera e parë që dëgjoj 15 vjet që kërkohet të mos ketë logo, mos të ketë emër të kryetarit të partisë. Nuk e paragjykoj pse e kanë këtë, por është ajo që ne kemi thënë që në fillim çadra e Partisë së Lirisë do të sjellë edhe çadrën e Partisë Demokratike. Ju faleminderit!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit BF: Tani Partia e Lirisë ka qenë edhe çadra juaj deri diku në qoftë se doni ta dini do më lësh të flas tani, të lutem...

Z. I. Celibashi: Të mbarojë njëherë kolegu, mbaruat zoti Salianji? Po, zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit BF: Nuk dua të bëj debat me zotin Salianjin se siç ju thashë në fillim të fjalës time, këta dy shokët e mi që kam këtu në krahun e djathtë dhe në krahun e majtë, janë të të njëjtës parti dhe kjo duket fare qartë. Tani pavarësisht kësaj, fakti është i tillë. Tani përsa i përket kohës që na keni lënë në dispozicion, duke konsultuar edhe vetë atë që është fryma e ligjit, neni 65, pika 3 e Kodit Zgjedhor, specifikimi i qëndrimit të mbajtur nga subjektet politike që janë pjesë e Koalicionit Bashkë Fitojmë, nuk e kanë një specifikim të tillë lidhur me vënien e emrit të ndonjë personi të caktuar si kryetar të subjektit që përfaqësoj. Kështu që Komisioneri tashmë e ka të qartë se çfarë duhet të ketë në fletën e votimit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Nuk duam ne të mburremi me emrat e kryetarëve të partisë siç do, kolegu Salianji të themi që në çdo pjesë të fletës po të kishte mundësinë, do të kishte vënë emrin e kryetarit të partisë së vet, as emrin e partisë, vetëm emrin e kryetarit. Kështu që ne këtë gjë nuk duam ta bëjmë, nuk do të bëjmë shfaqje politike në një fletë votimi, po do ta bëjmë fletë votimi kutë orientohen me të drejtën e ligjit dhe të Zotit votuesi. Jo më të orientohet me emrat e personave të caktuar. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po përfaqësuesi i Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet.

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Zoti kryetar do tju kërkoja ndjesë vetëm dy minuta, për shkak të përvojës prej shumë vitesh në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Është e habitshme që kjo tavolinë është kthyer në një fushatë elektorale apo biseda mes kolegëve tanë, kur jemi mbledhur për një çështje për sa i përket çështjes së fletës së votimit. Do të kërkoja mirëkuptimin e tyre dhe mirëkuptimin tuaj kryetar që gjithë këto debate, të cilat me një fjalë nuk shkojnë për mirë të këtyre mbledhjeve të komisionit në qoftë se është bërë bisedë e lirë hajde tregojmë se dhe ne dimë të flasim dhe të tregojmë se kush janë realisht të djathtët apo të majtët e vërtetë. Çështja është që jemi përpara faktit të një projektvendimi të ardhur për fletën e votimit. A është ligjore apo jo, është e saktë, e thjeshtë, konfondon zgjedhjet apo jo, dhe secili nga ne jep perceptimin e tij për këtë fletë votimi. Pjesa tjetër pastaj siç e sqaron edhe kodi ka hallka të tjera, KAS-i dhe të tjera për ta zgjidhur. Prandaj do tju lutesha zoti kryetar që ti kemi më të reduktuara këto biseda për sa i përket ngacmimeve personale shfaqjes politike që po bëhet. Në lidhje me fletën e votimit për sa i përket kandidatëve për kryetar bashkie, ne do të sygjeronim komisioni që të merrte në konsideratë për sa i përket, specimenin numër 1. Duke qenë dakord edhe me shpjegimet e kolegut, që është e thjeshtë, e pranueshme, është konform ligjit, ne

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

mendojmë që specimeni numër 1 të jetë ai që merret në konsideratë nga ana e komisionit. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Zoti Komisioner duke i krahësuar fletët e votimit nuk mendojmë që kjo pjesa e logos e ngarkon fletën e votimit përtej asaj që do të ishte kufiri ligjor, do të krijonte një informacion të tepërt, i cili mund të krijonte probleme me zgjedhësit. Kështu që, në këtë gjykim besojmë që për aq kohë sa zgjedhjet janë shumë afër, zgjedhësi të ketë mundësi që në fletën e tij të votimit të ketë maksimumin e informacionit të mundshëm për aq kohë sa ky informacion nuk mbingarkon fletën. Në këto kushte specimeni numër 3, i cili tregon në mënyrë të detajuar edhe logot e partive politike dhe të koalicioneve, jep informacionin më të madh të mundshëm për zgjedhësin pa e ngarkuar fletën. Ne do zgjedhim opsionin 3 zoti Komisioner.


Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit BF: A ju thashë që janë bashkë.

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Tani një sekond nëse do të hymë në çështjet e komenteve politike.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Tani edhe inceneratorët bashkë i bëni dhe ne jemi përsëri bashkë e kupton. Po tani kjo punë është...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit BF: Ne jemi denoncuesit e inceneratorëve shiko kush i ka bërë kallzimet.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Je, je, denoncues je, shikoji kallzimet. Kjo puna tani, se po e tolerojmë janë bashkë, se kush janë bashkë dhe kush ka qenë bashkë e njohin shqiptarët. Pra, qëndrimi im është konkret, ndryshimi i emrit nuk e ndryshon historinë.


Z. I. Celibashi: Ju lutem t'ia japim fjalën përfaqësueses së subjektit zgjedhor “Lëvizja Bashkë”.

Përfaqësuese e subjektit politik “Lëvizja Bashkë”: Faleminderit zoti Komisioner! Referuar tre varjanteve që kam këtu, varianti, ose specimeni 3 është është varianti më i përshtatshëm në gjykimin tonë, duke marrë parasysh të gjitha të dhënat që parashikon Kodi Zgjedhor dhe saktësinë e të dhënave të subjektit “Lëvizja Bashkë”. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Diskutime të tjera nuk kemi.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit BF: Të bëjmë një specifikim për sa i përket pjesës së orientimit të kodit, ligjvënësit, praktikës dhe të vetë qëllimit se jemi përpara zgjedhjeve të kandidatëve për kryetar bashkie, të cilë janë emra, platforma dhe personale. Nuk janë subjekte në vetvete, janë më shumë platforma personale, pavarësisht se janë të nxjerë nga subjektet dhe duhet promovuar emri, ndonëse normalisht është shënuar dhe subjekti të cilit i përket emri i kandidatit, kështu që duhet ta shohim në këtë frymë. Ligjënësi në këtë frymë e ka parë. Promovimi i emrit të kandidatit për kryetar bashkie dhe si i tillë mund të bëjmë rregullime tek emri dhe tek zmadhimi i shkronjave, ta bëjmë me bold, për aq sa teknikisht fleta e votimit do

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

e lejojë, në mënyrë që të shkojmë në atë që është praktika e konsoliduar, jo e vitit 2021, kur lindi në këtë komision kolegu Sefa, por e të gjitha viteve të tjera. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Me konceptin tuaj fare shkurt do të duhet që të përfundojmë nesër, por nëse keni ndonjë gjë thelbësore dhe do t'ju lutesha që të merrnit në konsideratë edhe këshillimi, të themi të kolegut të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet në lidhje me të paktën mënyrën e prezantimit të pretendimeve dhe padyshim mbi përmbajtjen e këtyre pretendimeve. Është mirë që të qëndrojmë tek thelbi i çështjes.

Z. R. Kthupi, përfaqësuesi i PD-së: Dakord faleminderit! Atëherë do të vazhdojmë tek interpretimi që bën zoti Kaziaj është “Të theksojmë emrin e kandidatit” sepse kandidati hyn në këtë fushatë për të kandiduar i vetëm, për të provuar i vetëm dhe për të drejtuar i vetëm. E vërteta e fushatës elektorale është që kandidati është emri që përzgjidhet nga një parti politike. Në rastin konkret përzgjidhet nëpërmjet strukturave apo nëpërmjet primareve. Ky kandidat pretendon të zbatohet në një fushatë, një program që është një program i partisë politike. Nuk është program individual i kandidatit sepse nëse do të ishte i tillë do të kishte dalë si kandidat i pavarur. Mbështetet mbi votat e partisë politike, kështu që diferencimi i thelluar ndërmjet kandidatit dhe partisë politike duke shmangur praninë e logos në fletën e votimit gjykoj që nuk përkon me atë që është realiteti i fushatës elektorale. Në këto kushte informacioni për aq kohë sa kandidati është kandidat i prodhuar nga një subjekt politik. Është kandidat që mbështet fushatën me një program të prodhuar nga një parti politike, që mbështetet nga një grup këshilltarësh të të njëjtit subjekt politik, duhet që në fletën e votimit ky kandidat të identifikohet edhe me subjektin politik. Shkak për të cilin logo është element shtesë dhe i domosdoshën në gjykimin tonë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Celibashi: Por nuk keni kërkesa që në rastin e fletës së votimit për kandidatët për kryetar të jetë dhe emri sipas jush i kryetarit të koalicionit.

Z. R. Kthupi, përfaqësuesi i PD-së: Jo, nëse do të nisem në kushtet e kësaj kërkesë atëherë ne mendojmë që palët të jenë të lira të zgjedhin nëse e duan logon apo jo në fletën e votimit.

Z. I. Celibashi: Dakord!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: Ja ku i keni specifikimet e fletës së votimit 2015, nuk është logoja. Ja ku i keni 2015 për kryetar për kandidat, nuk është logoja. Për vitin 2019 nuk është logoja. Në erën e Sefës është futur logoja.

Z. I. Sefa, përfaqësuesi i PD-së: Edhe zjarri me gurë ndizej por ecën, ka mjete të tjera që nga epoka e gurit, por problemi është këtu... Zgjedhjet janë në evolucion zoti Komisioner dhe meqë jemi në këtë moment edhe ka parti që nuk e duan logon sepse nuk i përshtatet dhe nuk i vjen përshtat, mbase ndjehen dhe keq nga logo kanë të drejtë. Propozimi jonë është që kush do ta heqë, le ta heqë. Ne e duam.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet?

Z. Sh. Sulo, përfaqësuesi i PDIU-së: Të lutem zoti kryetar do të kërkoja edhe një herë nga kolegët që duam apo nuk duam ne logo apo jo. Të lutem mos të na bëjnë ne profesorin se si të flasim apo jo. Kryetar dhamë variantin tonë, jemi për specimenin 1, kërkojmë që propozimi të merret në konsideratë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Celibashi: Dakord! Nëse nuk keni argumente të tjera unë mendoj që ta përfundojmë diskutimin në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për kryetar të Bashkisë Tiranë. Në vlerësimin tim për mos të përsëritur të gjithë argumentet ligjore që në pjesën më të madhe të dhënat e tyre qëndrojnë sikurse i prezantova në diskutimin dhe arsyetimin mbi fletën e votimit për këshillin. Duke marrë në konsideratë edhe faktin që edhe në zgjedhjet e kaluara, në zgjedhjet e pjeshme për organet e qeverisjes vendore, logo ka qenë element përbërës i fletës së votimit dhe nuk është çështje e zgjedhjes së vullnetit të palëve. Mendoj që ky version nëse nuk gaboj është treshi si specimen. Me parjen e mundësisë nëse emrat e kandidatëve, meqenëse votimi është për ta, mundet nëse do ta lejojë madhësia e fletës së votimit do të jenë pak më të spikatura. Kjo do të jetë përmbajtja e fletës së votimit. 3-shi si specimen. Kjo kështu do të miratohet, sipas specimenit 3. Dakord!
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Për këdo që do të ankimojë këtë vendim, brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve. Nga dita e sotme fillon afati.

Vendim nr. 360

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

15.04.2023
Ora 13.12

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak në 60 bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.”

PJESËMARRJA :

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan CELIBASHI**
- Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj.**
- Parti politike: **PD, PDIU, PS, BF, Lëvizja Bashkë**
- Të tjerë: **KRIIK, ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me përmbajtjen e fletëve të votimit për kryetar për bashkitë e tjera, por besoj që do të jetë e njëjta përmbajtje, e njëjta, nuk kemi ndonjë diskutim. Po i miratojmë sipas lidhjeve respektive për 60 bashkitë e tjera, fleta e votimit, përmbajtja e fletës së votimit për kryetar, po kështu edhe për këshillin bashkiak, fleta e votimit për këshillin bashkiak, i miratojmë sipas lidhjeve përkatëse, në reflektim edhe të ndryshimeve që bëjnë edhe për fletën e votimit për Këshillin e Bashkisë Tiranë. Mirë faleminderit, kemi çështje tjetër? Nuk kemi, mirë faleminderit!

Vendimi nr. 362, 363

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

15.04.2023
Ora 12:29

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për Kryetar Bashkie i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste”, për Bashkinë Mallakastër”.

PJESËMARRJA:

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Znj. M. Koja**
- **Parti Politike:** **PS, PD, PDIU, “Bashkë”**
- **Të tjerë** **KRIIK, OSBE\ODIHR**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës që lidhet me verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për subjektin vetëdeklarues zotin Qerim Ismail Ismailaj. Në lidhje me këtë çështje, shoh që është përfaqësuesi i kandidatit, ju lutem prezantohuni.

Z. A. Skënderi, përfaqësues me prokurë i zotit Qerim Ismail Ismailaj: Prezent avokat Andi Skënderi. Kam qenë edhe në seancën e kaluar ku jam legjitimuar kështu që në kuadër të kësaj vazhdojmë me diskutimin.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë fjala direkt për ju dhe nëse përfaqësuesit e partive politike kanë për të diskutuar në lidhje me këtë çështje, pasi ti japim fjalën përfaqësuesit të kandidatit.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Është kandidat i Partisë Socialiste.

Z. I. Celibashi: Dakord! Fjala është për përfaqësuesin e Partisë Socialiste.

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Tani së pari gëzoj që për sa i përket zbatimit të Ligjit të Dekriminalizimit, ne si subjekt zgjedhor, si subjekt parlamentar kemi qenë promovuesit e këtij ligji si edhe zbatuesit e tij. Në asnjë rast ne nuk kemi mbështetur asnjë kandidat, ose të zgjedhur nga ana e Partisë Socialiste, ndër të cilët i kanë dalë probleme me Ligjin e Dekriminalizimit dhe të kemi ardhur këtu në komision ta mbrojmë. Pra këtu kemi qenë se cili deputet, kryetar bashkie i kanë dalë probleme me ligjin ne kemi dhënë dakordësinë tonë që rasti të shqyrtohet, të verifikohet dhe nëse më pas del që është i dënuar, patjetër të lërë mandatin. Ka patur edhe heqje dorë në mënyrë vullnetare nga mandati për deputet të caktuar të cilët kanë dalë në shkelje të Ligjit për Dekriminalizimin. Besoj ky është rasti konkret për sa i përket kandidatit të Partisë Socialiste në Mallakastër, Qerim Ismailaj. Ky është një rast që është denoncuar, gjykuar nga ky komision si dhe nga gjykata Shqiptare. Për sa i përket faktit në të cilën...dhe këtë dua ta bëj dhe me dije në fakt edhe historinë e këtij procesi për arsye se nëse do të ishte ndonjë rast i një kandidati tjetër, i cili do të kishte një dënim nga këto që i parashikon Ligji për Dekriminalizimin, dënim jashtë, ne patjetër nuk do të jepnim mbështetjen tonë, por do të kërkonim që ai të ç'regjistrohej, mos të ishte pjesë e kandidimit. Në rastin konkret, në rastin e zotit Qerim Ismailaj është një dënim i dhënë nga një shtet i huaj për sa i përket një vepre penale, në të cilën nuk parashikohet heqja e mandatit për kryerjen e kësaj vepre, por është gjykuar rasti që përse nuk e ka deklaruar. Një sherr midis të rinjsh, shumë vite më parë në Greqi nga ky kandidat. Për këtë mosdeklarim është gjykuar zoti Ismaili dhe kemi një vendim nga Gjykata Shqiptare, jo për sa i përket shkeljes për të cilën e ka kryer dënimin në



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Greqi, por vetëm për mosdeklarimin e këtij fakti në formularin e dekriminalizimit për sa i përket këtij lloj dënimi. Dhe dënimi ka qenë një vendim për rrahje në të cilën nuk parashikon ligji që hiqet mandati për këtë lloj dënimi. Gjykata e ka dënuar zotin Ismaili me 6 muaj burgim dhe e ka konvertuar këtë dënim në bazë të nenit 63 me punë detyruese dhe ligji në këtë rast, ky parashikim i Kodit Penal në dhënien e këtij vendimi, për sa i përket këtij lloj dënimi, quhet një dënim i paqenë thuhet në nenin 63 i Kodit Penal në momentin e kryerjes. Zoti Ismaili është gjykuar, është dënuar, e ka kryer punën detyruese dhe në këtë moment Kodi Penal e quan të padënuar këtë subjekt. Ne kemi marrë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Krimit dhe Korrupsionit të Organizuar, kemi marrë gjithë praktikën e gjyqimit dhe shlyerjes së dënimit si dhe vërtetimin nga kjo prokurori e cila përcakton se ky shtetas është i padënuar. I nderuar kryetar, nuk e di a jeni në dijeni, pavarësisht nuk e di nëse e keni kryer një veprim paraprak, unë jam i detyruar t'ju vë në dispozicion të gjithë praktikën e prokurorisë dhe gjykatës. Prokuroria e Posaçme Kundër Krimit dhe Korrupsionit vendosi: “Përfundimin e dënimit alternativ për të pandehurin Qerim Ismailaj. Mbase është konstatuar se është kryer dënimi ka vendosur ta konsiderojë dënimin alternativ të dhënë në vendimin penal 105, 112 dt. 02.02.2023 të Gjykatës Penale të Shkallës së Parë për të pandehurin Qerim Ismailaj, për përfundimin e punës së kryer dhe dënimi konsiderohet i paqenë”. Pra thashë mos kemi ndonjë vendim që ky lloj dënimi konsiderohet i paqenë. Është praktika... do jua vëmë në dispozicion. Do të thotë që duke llogaritur të *(nuk dëgjohet)* të Ligjit për Dekriminalizimin, i cili kërkon një dënim, në rastin konkret nuk e kemi këtë dënim, unë kërkoj nga ana juaj të vazhdojë kandidimi. Do ju vë në dispozicion këto dokumente. Kemi dhe të shërbimit të provës si dhe vendimin e gjendjes gjyqësore që ka dalë mbase kanë ndodhur të gjitha këto fakte që i paraqita, ka dalë është i padënuar. Pra sot më vjen shumë mirë që Ligji për Dekriminalizimin i ka dhënë efektet e tij dhe sot po diskutojmë për një vendim i cili



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

ka ardhur për shkak të mosplotësimit të formularit të Ligjit për Dekriminalizimit. Pra nuk kemi një dënim siç kemi parë këtu të akuzuar për vepra penale, vjedhje, trafik droge etj.etj., por veprimi për të cilin u dënua zoti Ismaili, e kreu punën, kërkojmë këtu ta dënojmë, ta pushkatojmë. Pra nuk mundet... kur e ka zgjidhur kodi penal që ky dënim quhet i paqenë, nuk mundet nëpërmjetë KQZ-së ne ta diskutojmë këtë lloj precedenti. Unë do të kërkoja pushim e procesit administrativ dhe vashdimin e kandidimit të zotit Ismailaj.

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Salianji! Diskutime të tjera?

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. E. Salianji: Më vjen shumë mirë që ai ligji i dekriminalizimit i ka dhënë efektet e tij, dhe sot po diskutojmë për një vendim në të cilët ka ardhur për shkak të mosplotësimit të formularit të ligjit të dekriminalizimit, pra nuk kemi një dënim siç kemi parë këtu të akuzuar për vepra penale, vjedhje, trafik, drogë e të tjerë, e të tjerë, por veprimin të cilin u dënua zoti Ismailaj, e kreu punën, kërkojmë këtu ta dënojmë, ta pushkatojmë. Pra nuk mundet, kur e ka zgjidhur Kodi Penal, që këtë lloj dënimi, ky dënim quhet i paqënë, nuk mundet nëpërmjet KQZ-së ne ta diskutojmë këtë lloj precedenti. Unë do kërkoja pushimin e procesit administrativ dhe vazhdimin e kandidimit për zotin Ismailaj. Ju vë në dispozicion provat kryesore.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit zoti Salianji! Diskutime të tjera?

Përfaqësuesi i PD: Mund t'i shoh pak unë?

Z. I. Celibashi: Po, të lutem jepja përfaqësuesit të Partisë Demokratike dokumentacionin.

Z. R. Kthupi: Atëhere parimisht zoti Komisioner, çështja që shtrohet është, domethënë pretendimi që ngrihet nga Partia Socialiste është se për shkak se dënimi është kryer jemi në kushtet e një dënimi të paqënë. Në të vërtetë pika ç, e nenit, e ligjit 138/2015 thotë egzistencën e dënimit, do të thotë jemi në kushtet ku është kryer një dënim, dhe dënimi është jo më pak se 6 muaj burgim, se çfarë ndodh më pas me dënimin, nëse ky dënim kryhet, nëse quhet i paqënë për shkak të kryerjes së tij, nuk zhbën faktin që dënimi është dhënë dhe dënimi është marrë. Në rastin konkret të zotit Ismailaj jemi në kushtet kur ka një vendim të gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, vendim i cili vendos një dënim për 6 muaj burgim, pastaj i cili

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

në bazë të dispozitave, në zbatim të dispozitave të tjera të Kodit Penal, Kodi i procedurës Penale, është ulur, reduktuar dhe zëvendësuar me një dënim tjetër alternativ. Diferenca që kemi në interpretimin e ligjit është, ekzistenca e dënimit është shkak i kufizues dhe pezullues për të cilin zoti Ismailaj nuk mund të kandidojë, se çfarë ka ndodhur me zbatimin apo me ekzekutimin e këtij vendimi, dhe pasojat që ekzekutimi i këtij vendimi sjell në formularin e gjëndjes gjyqësore të tij nuk e zhbëjnë këtë pengesë. Në këto kushte për aq kohë sa egziston ky vendim, dënimi është dhënë në sasinë e kërkuar në dispozitë e nenit 138 jemi në kushtet ku nuk mund të kërkohet kandidimi.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

Z. I. Sefa: Siç jeni në dijeni dhe ju, në neni 4, pika 9, të ligjit 138/2015 është e përcaktuar fare qartë dispozita ku thotë, ulja mbas dënimit për shkak të gjyqimit të shkurtuar, apo procedure të ngjashme me të, sjell uljen e dënimit. Amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht, apo çdo shkurtim denimi në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përlllogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimit parashikuar nga ky ligj, domethënë, edhe për periudhën e ndalimit nuk merret gjykimi i shkurtuar, domethënë edhe për periudhën e ndalimit. Gjithashtu thotë, ky ligj nuk zbatohet për dënime të dhëna për dispozita që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese pas dhënies së dënimit përkatës depozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit. Pra zoti Komisioner, dispozita është fare e qartë, neni 63 me të cilin përfaqësuesit e zotit Ismailaj pretendojnë që ky dënim konsiderohet i paqënë e të gjitha me rradhë, pasi është ekzekutuar në titull të tij thotë 'pezullimin e dënimit me kryerjen e një pune me

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

interes publik, domethënë që në titull, që në titull, referohet pezullimi i dënimit, që do të thotë, në bazë të pikës 9, të nenit 4, pezullimi i dënimit nuk mund të merret në konsideratë. Fakt tjetër zoti Komisioner, ka të bëjë dhe me provën që ne kemi paraqitur, që dënimi ka marrë formë të prerë vetëm dy ditë mbas regjistrimit të zotit Ismailaj si kandidat për Kryetar Bashkie, në Bashkinë Mallakastër, që do të thotë se deri në atë datë, ky vendim deri në datën 27 kur është bërë regjistrimi, nuk dihej akoma do ankimohej apo jo, nuk kishte marrë akoma formë të prerë, dhe është vetë gjykata që ka referuar që ka marrë formë të prerë në datë 29. Gjithashtu pika 9, i referohet edhe dispozitës së nenit 69, të Kodit Penal, periudha e ndalimit, e cila sipas këtij ligji, pika 4 më fal e këtij ligji, neni 4, pika 4, thotë që periudha e ndalimit do t'i referohemi nenit 69, neni 69, i Kodit Penal, i referohen që për deënimet mbi 6 muaj burgim periudha e ndalimit është 2 vjeçare, prandaj zoti Kryetar ne jemi në kushtet që ky kandidat është në pengesë ligjore dhe Komisioneri duhet të vendosi ndalimin e kandidimit, duke qënë se është në kushtet e ndalimit të përcaktuar në ligjin 138 të vitit 2015. Faleminderit! Dhe diçka të fundit të mos harroj, dispozita e posaçme në këtë rast që është ligji mbi dekriminalizimin, prevalon mbi Kodin Penal, dhe Kodin e Proçedurës, sepse është dispozitë e posaçme, që është bërë për një qëllim të caktuar, në rast se Kodi Penal dhe Kodi i Proçedurës Penale ka dispozita të përgjithshme, për raste të përgjithshme, në momentin që bëhet një dispozitë e posaçme ajo duhet të këtë prioritet në zbatim, sepse dhe rregullat e përcaktuara në të janë për zbatimin e asaj dispozite ligjore, edhe pikërisht ky ka qënë dhe vullneti i legjislatorit ku ka përcaktuar në nenin 4, pikën 9, që thotë për raste të pezullimit të dënimit apo të gjykimit të shkurtuar, nuk duhen llogaritur po duhet marrë masa e dënimit, në këtë rast masa e dënimit është 6 muaj dhe është brënda përcaktimit ligjor të afatit që është në ndalim në Kodin, në ligjin e dekriminalizimit.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. I. Celibashi: Kemi diskutime të tjera? Po, përfaqësuesi i Partisë Socialiste.

Z. E. Saliانji: Siç e parashtrova dhe gjatë shqyrtimit, dispozita e nenit 63, në të cilën është parashikuar dënim alternativ, dhe këtë lloj dënimi e quan dënim të paqënë, është një dispozitë që nuk është parashikuar në mënyrë ndaluese nga ligji për dekriminalizimin, është e vetmja dispozitë, pra nëqoftëse do kishim pezullim dënimi, dënim me kusht, gjykim të shkurtuar jam dakord me parafolësin, që nuk mundet ne të gjykonim sot që ky kandidat do t'i shpëtonë heqjes së mandatit, është e vetmja dispozitë që nuk është vënë nga legjislatori, tani e kanë vënë ata, e kanë harruar këtë dispozitë, e kanë lënë qëllimisht ose nuk është vendosur në këtë ligj ne nuk mund ta interpretojmë, ne sot lexojmë ligjin dhe jemi të detyruar të lexojmë vetëm ligjin, sidomos në një rast si ky që ka të bëjë me heqjen e kandidimit, është një e drejtë themelore kushtetuese e një subjekti, të cilit ti t'i ndalosh kandidimin me interpretim. Sot kemi Kushtetutën në miratimin e ligjeve, kemi Kodet pastaj ligjet. Kushtetuta e lejon kandidimin, Kodi Penal i cili vjen mbas Kushtetutës në hierarkinë e ligjeve, ja jep benefitin që të quhet i padënuar, ligji i posaçëm nuk e ka përmendur specifikisht që në qoftë se personi dënohet në bazë të nenit 63, dhe me punë në interes publik atëhere nuk mund të përfitojë nga kjo, nuk e ka parashikuar, ne nuk mund ta interpretojmë, as ne as dhe ju Komisioner, por thjesht duhet të jemi rigoroz mbi ligjin dhe besoj ky është rasti në të cilin ligji i dekriminalizimit nuk gjen fushë zbatimi. Jo se e kërkojmë ne por se është konform ligjit dhe ky person të cinin sot flitet si i dënuar, nuk është i dënuar për ndonjë vepër që ne kemi rënë dakord, subjektet politike, që nuk duhet të kandidojë, për vet formularin e dekriminalizimit, pra për atë veprim që ka kryer nuk e ka deklaruar është dënuar, ne nuk mund ta dënojmë për herë të dytë. Është dënuar, e ka kryer dënimin, ka kryer atë punën

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

detyruese, ligji ja ka dhënë këtë benefit dhe ne duhet thjesht ta zbatojmë.
Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, kemi diçka tjetër për të shtuar para se ta përfundoj? Nuk kemi gjë tjetër, mirë, faleminderit! Atëhere në fakt duhet thënë që nga pikëpamja ligjore si kasus meritonte gjithë diskutimin që kemi bërë, dhe që bëmë edhe sot, ndaj dhe për këtë arsye vendosëm për ta shtyrë, ose për të vazhduar dhe një seancë tjetër shqyrtimin e kësaj çështje, në vlerësimin tim jemi në kushtet kur subjekti në fjalë nuk ka ndalim për këtë arsye, për këtë shkak, për të kandiduar. Nuk jam dakord për atë çfarë tha përfaqësuesi i Partisë Demokratike në lidhje me fuqinë që kanë kundrejt njëra tjetrës Kodi Penal me ligjin për dekriminalizimin. Kodi Penal në çdo rast është unik dhe i vetëm dhe i posaçëm, përse i përket kush është i dënuar, masës së dënimit, kur nuk është më i dënuar e të tjera si këto, dhe procedura penale për rastin e gjyqimeve të caktuara, gjykim i shkurtuar apo gjykim i plotë. Pra i vetmi ligj i cili na tregon ne nëse një person është i dënuar apo i padënuar është Kodi Penal. Ligji për dekriminalizimin i vlerëson sipas interesit të tij, edhe kur një person në disa raste mund të rezultojë le të themi që nga pikëpamja formale për Kodin Penal të jetë i dënuar, ai të mos ndalohet të kandidojë, apo dhe anasjelltas. Pra ligji për dekriminalizimin vlerëson atë çfarë ka prodhuar Kodi Penal, në çdo rast, jo në vetvete ligji për dekriminalizimin disponon mbi cilësitë e një personi bazuar në rekordet e tij penale, për të kandiduar ose për të moskandiduar. Pra kjo e para, në rastin konkret subjekti në fjalë për ligjin penal është i padënuar, i paqënë, as i padënuar por është i paqënë, nuk ka egzistuar, presupozohet që nuk ka egzistuar ky dënim, përndryshe ligjvënësi do të thoshte i padënuar, sikurse ligji për dekriminalizimin do ta kishte ilustruar dhe në këtë. Nuk ka më mbaruan, të lutem, mos më ndërpriri të lutem. Po në rastin në fjalë, sipas nenit 63, të Kodit Penal subjekti

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

nuk është as i rehabilituar, as i dënuar me kusht, apo ndonjë formë tjetër të veprimit të ligjit penal, për të gjithë ne të tretët ai konsiderohet i paqënë, nuk egziston. Është zgjedhja e ligjvënësit për këtë rast, pse e ka krijuar këtë avantazh për një kategori veprash penale të caktura dhe masash dënimi penal të caktuara, por është kështu, për këdo të tretë tjetër konsiderohet i paqënë, nuk është se është dënuar, u rehabilitua. Është i paqënë, nuk egziston si dënim, dhe natyrisht kur janë plotësuar kushtet, pra kur është përmbushur kushti për të kryer dënimin alternativ, sikurse dhe rezulton nga dokumentacioni që ka dërguar organi i prokurorisë ku thotë që i ka përmbushur i pandehuri Qerim Ismailaj detyrimin alternativ dhe në përfundim të punës thotë ndaj i pandehur Qerim Ismailaj dënimin konsiderohet i paqënë, kështu që në këto kushte vlerësoj që nuk ka ndalim për atë si, nga pikpamja e ligjit, dhe në interpretimin strikt, gërmë për gërmë të ligjit formal, nuk ka ndalim për të që të jetë kandidat për Kryetar të Bashkisë në zgjedhjet e 14 majit. Tejt kësaj, meqënëse dhe kjo në respektim tërësisht rigoroz dhe formal të gërmës së ligjit, meqënëse në formularin e tij të vetdeklarimit, ai pyeti edhe a keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë më shumë se një muaj, i është përgjigjur me po, dhe pyetjes a keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga ndonjë autoritet i huaj për ndonjë vepër penale, i është përgjigjur me po, është rasti për ta dërguar, apo ridërguar le të themi pranë organit të prokurorisë për hetim të thelluar, nëse bëhet fjalë për të njëjtat raste që më parë janë vlerësuar, është çështje që ngelet për tu diskutuar më pas, por si Komisioner nuk mund të presupojoj dhe të marr të mirqënë që bëhet fjalë për këto raste, kështu që do duhet të presim informacionin përkatës nga organi i prokurorisë në lidhje me këto dy momente. Ndërsa përsa i përket momentit të parë, sikurse e thashë, në zbatim të nenit 63, të Kodit Penal, ai nuk ka ndalim. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2023*

Z. E. Salianji: Tashmë këto lloj vendimesh, ta sqarëjmë, këto vendime nuk ankimohen nga procesi tashmë i konsoliduar i KAS-it dhe legjitimitetit të personave.

Z. I. Celibashi: Nuk e di, nuk vendos, palët e interesuara vlerësojnë vet dhe institucionet e interesuara, nëse janë të interesuara apo kanë kompetencën, gjykojnë vet.

Z. E. Salianji: Mirë po të gjykohet në disponim, kur jepet e drejta ankimit, thjeshtë.

Z. I. Celibashi: Komisioneri deri këtu e kishte përgjegjësinë. Faleminderit! Panvarsisht se si mund të shprehem unë për ankimin, afatin e ankimit palët nuk i ndalon ligji nëse vlerëson se ka vend për ankim dhe ku mund të bëhet ankimi. Faleminderit! Seanca mbyllet, kalofshi mirë me Pashkët edhe fundjavë të mbarë.

Z. E. Salianji: Me leje, për vendimmarrjen e fletës së votimit që thamë për një orë, apo...

Z. I. Celibashi: : E kemi marr konfirmimin? Nuk e kemi marr për atë. Mirë po presim dhe një konfirmim nga përfaqësuesit e koalicionit, ndoshta presim, fillojmë pas 5 minutash ose 10 minutash.

Vendimi nr. 366

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

